# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5687
E hënë, 27 janar 2019
çmimi 0.40 €

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"


## Thaçi: Në ditët e ardhshme institucionet do të marrin vendime në interes të shtetit

FAQE 7




AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", RASHIT QALAJ FAQE 4-5

# Objektivi i policisë, luftimi i krimit dhe korrupsionit



Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, ka bërë me dije se janë marrë një sërë masash për parandalimin e vjedhjeve dhe plaçkitjeve. Ai ka thënë se policia është duke identifikuar kryerësit e këtyre veprave penale dhe së shpejti do t'i sjellë para drejtësisë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Qalaj ka thënë se luftimi i krimit dhe korrupsionit është objektivi kryesori i policisë. Sipas tij, luftimi i krimit dhe korrupsionit duhet të bëhet për të ardhmen e vendit dhe jo për shkak të liberalizimit të vizave dhe integrimeve evropiane. Qalaj ka kërkuar ndihmën e institucioneve që Policia e Kosovës të bëhet sa më shpejt me sigurim shëndetësor dhe sigurim jetësor. Ai ka bërë me dije se Policia e Kosovës edhe këtë vit do të bëjë përpjekje për t'u anëtarësuar në Interpol



NË VARREZAT E KRYEQYTETIT ËSHTË VARROSUR ZËVENDËSMINISTRI I DIASPORËS, ARIAN DACI

# I jepet lamtumira e fundit Arian Dacit

FAQE 3

Me nderime të larta, qindra qytetarë dhe liderë institucionalë të dielën e kanë përcjellë për në banesën e fundit zëvendësministrin e Diasporës, Arian Daci, i cili ka humbur jetën nga një ortek bore në Brezovicë të shtunën në mesditë. Pas homazheve në hollin e Kuvendit të Kosovës, në nderim të të ndjerit është mbajtur edhe një mbledhje përkujtimore, ku është vlerësuar lart personaliteti i Arianit, djalit të vetëm të kryetarit të AShAK-ut, Nexhat Daci



## AKTUALE



### ISMAIL QEMALI, SHEMBULLI HISTORIK F. 11

Rexhep QOSJA

### KURTI PARALAJMËRON PROTESTA F. 7

### SONDAZH: RRETH 43 PËR QIND E QYTETARËVE NUK E PËRKRAHIN GREVËN E SBASHK-ut F. 6

## EKONOMI



### ZONË EKONOMIKE PËR JOSHJEN E INVESTITORËVE AMERIKANË F. 9

### KOSOVA DO TA KRYESOJË PËR DY VJET DITËN BOTËRORE TË PASTRIMIT F. 8

## KULTURË

### IZET SARAJLIQI, KY BALLKANAS I METAMORFIZUAR F. 17

Albin MEHMETI

## SPORT

### BRUQI: GARA PËR MBIJETESË, E VËSHTIRË, FLAMURTARI MBETET NË SUPERLIGË F. 22

### NISHEVCI E KARAQI MORËN PIKË OLIMPIKE NË PARIS F. 22


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Basha i fton të larguarit nga PD-ja












TIRANË, 27 JANAR - Zgjedhjet e 30 qershorit do të jenë një pikë kyçe për fatin e Shqipërisë dhe rrugën e saj evropiane, pavarësisht se janë për nivelin lokal të qeverisjes. Por, përveç Shqipërisë, këto zgjedhje do të vlejnë shumë për ta testuar elektoratin dhe për Lulzim Bashën, kjo do të thotë shumë pasi në PD kanë nisur të dalin zëra se ai duhet të japë dorëheqje nëse dështon.
Fitorja e Tomorr Alizotit si kundërshtar i tij në Kryesinë e re të PD-së, por edhe ftohja me një prej më të besuarve të tij, Ervin Salianjin, që po i dërgon çdo ditë mesazhe të koduara për dorëheqjen, nuk e vendosin në pozita komode kreun e PD-së, i cili ka vendosur të ecë paralelisht me organizmin e protestave për ta rrëzuar Edi Ramën dhe ndezjen e motorëve për zgjedhjet lokale.
Forcat opozitare shpresojnë që nëpërmjet protestave të arrijnë te qeveria transitore dhe zgjedhjet e parakohshme, ndaj Basha objektivat e PD-së i ka bërë të qarta edhe në udhëzimin e ri për degët.
Kryesia e re e PD-së caktoi 16 shkurtin si ditën e protestës mbarëkombëtare kundër Qeverisë, njëkohësisht ajo ka filluar të përgatitet edhe për zgjedhjet. Sipas medieve, në një udhëzim të shpërndarë për deputetët dhe anëtarët e kryesisë nga kryetari Lulzim Basha dhe sekretari i përgjithshëm Gazmend Bardhi, kërkohet fillimi i punës për ngritjen e shtabeve elektorale në çdo degë lokale.
Udhëzimi thotë se duhet të nisë puna për identifikimin e personave që do të jenë në shtabet elektorale në zbatim të vendimit të kryesisë.
Me vendim të Kryesisë në këtë udhëzim theksohet se duhet të identifikohen dhe thirren të gjithë ata persona që kanë kontribuuar për Partinë Demokratike nga viti 1991, qofshin ata ish-deputetë apo ish-kryetarë bashkish e komunash.
Kërkesa për bashkim forcash me të larguarit e të përjashtuarit është një thirrje që Lulzim Basha e ka bërë edhe më parë, madje duke u shprehur se do t'ua shtrijë dorën e pajtimit kritikëve, por thuajse ka dështuar.
Por në një kohë kur të gjithë të ikurit nga PD-ja mendojnë dhe e kanë shprehur se Edi Rama është problemi kryesor i vendit, mbetet të shihet se si ata do ta interpretojnë këtë lëvizje të re të kryetarit të opozitës.

# "Maqedonia e Veriut", lëvizjet që do t'i bëjnë Athina dhe Shkupi

Pas pranimit zyrtar të emrit, zyrat e deritanishme për lidhje me Shkupin dhe Athinën do të shndërrohen në ambasada, kurse një prej pikave më ambicioze të ujdisë është dhe krijimi i një "komisioni të përbashkët ndërdisiplinor ekspertësh", i cili do të verifikojë nëse tekstet shkollore, harta dhe atlaset historike duhen rishikuar gjithashtu në të dy vendet



SHKUP, 27 JANAR - Pas një konflikti 27-vjeçar, marrëveshja historike e emrit të Maqedonisë u zgjidh me kapërcimin e pengesës së fundit, votimit në Parlamentin grek dhe dritës jeshile të dhënë atje ujdisë që sërish nuk pranohet nga gati 2/3 e grekëve.
Deri në mbrëmjen përpara votimit, jashtë ndërtesës së parlamentit pati përleshje të dhunshme e turma lëshoi fishekzjarrë dhe flakadanë, duke lënë kështu të kuptohet se çfarë niveli pakënaqësie ka mes popullatës për atë që politika e sheh si arritje historike.
Për Aleksis Tsipras, vulosja e paktit nuk vjen pa kosto: sondazhet tregojnë se kryeministri grek do t'i humbasë zgjedhjet e këtij viti. Arsyeja e një kundërshtie kaq të madhe në popull është provinca më të njëjtin emër në veri të shtetit helen; grekët kanë njëkrenari gati të egër për trashëgiminë e Aleksandrit të Madh dhe të atit, Filipit II, dhe në të gjithë këtë ngërç, janë gërryer nga dyshimi i ambicieve të mundshme territoriale të vendit fqinj.
Por tani që pakti e mori dritën jeshile të Parlamentit grek, çfarë ndodh me Maqedoninë? Ajo do të bëhet Republika e Maqedonisë së Veriut pas rreth dy javësh kur, sipas procedurës, marrëveshja e Prespës duhet të hyjë në fuqi.
Presidenti grek duhet t'i vërë firmën e tij Ligjit për ratifikimin e marrëveshjes së Prespës e ai të botohet në Gazetën Zyrtare. Publikimi do të bëhet sot (e hënë) dhe me këtë ligji bëhet zyrtar.
Më tej, Athinës do t'i duhet ta njoftojë sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, se pakti është ratifikuar; ndryshimi i emrit do të bëhet përfundimtar pasi ambasadorët e Aleancës veriatlantike ta kenë firmosur në Bruksel anëtarësimin e saj dhe Parlamenti grek ta nënshkruajë atë protokoll. Greqisë do t'i kërkohet, po ashtu, t'i mbështesë edhe përpjekjet maqedonase për aderim në BE. Shkupit, nga ana e tij, do t'i duhet të dërgojë shënim në Greqi dhe në OKB, se marrëveshja hyn në fuqi. Pas pranimit zyrtar të emrit, zyrat e deritanishme për lidhje me Shkupin dhe Athinën do të shndërrohen në ambasada. Një prej pikave më ambicioze të ujdisë është edhe krijimi brenda një muaji i një "komisioni të përbashkët ndërdisiplinor ekspertësh", i cili do të verifikojë nëse tekstet shkollore, harta dhe atlaset historike, duhen rishikuar gjithashtu në të dy vendet. Një proces i tillë me të gjitha gjasat ka për të qenë mjaft sfidues për shkak të ngjyrimeve të dhëna nga palët dhe variantet e mbështetura prej tyre të së vërtetës.

## VMRO-DPMNE, nismë për shpërbërjen e Kuvendit

SHKUP, 27 JANAR -VMRO-DPMNE-ja në mbledhjen e së dielës të organeve drejtuese të partisë ka vendosur të ngrejë nismë për shpërbërjen e Kuvendit dhe shkuarjen e vendit në zgjedhje të parakohshme parlamentare të cilat, sipas partisë së Mickoskit, do të mbaheshin bashkë me zgjedhjet presidenciale.
Në ndërkohë lideri opozitar ka kërkuar dorëheqjen e kryeministrit Zaev dhe formimin e një qeverie teknike e cila do t'i organizonte zgjedhjet eventuale. "Grupi i deputetëve të VMRO-DPMNE-së të hënën në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë do ta dorëzojë kërkesën për dorëheqjen e kryeministrit Zoran Zaev, formimin e Qeverisë teknike dhe iniciativën për shpërbërjen e Kuvendit", deklaroi Hristijan Mickoski, menjëherë pas mbledhjes së kryesisë së partisë së tij.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Në varrezat e kryeqytetit është varrosur zëvendësministri i Diasporës, Arian Daci

# I jepet lamtumira e fundit Arian Dacit

**Me nderime të larta, qindra qytetarë dhe liderë institucionalë të dielën e kanë përcjellë për në banesën e fundit zëvendësministrin e Diasporës, Arian Daci, i cili ka humbur jetën nga një ortek bore në Brezovicë të shtunën në mesditë. Pas homazheve në hollin e Kuvendit të Kosovës, në nderim të të ndjerit është mbajtur edhe një mbledhje përkujtimore, ku është vlerësuar lart personaliteti i Arianit, djalit të vetëm të kryetarit të AShAK-ut, Nexhat Daci. Bashkëpunëtorët e tij më të ngushtë kanë deklaruar se Ariani ishte burrë i ndershëm, që e ka dashur vendin dhe i ka shërbyer me devotshmëri**



EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË. 27 JANAR - Zëvendësministrit të Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Arian Daci, të dielën i është dhënë lamtumira e fundit. Me nderime të larta, trupin e pajetë të të ndjerit, i cili humbi jetën nga një ortek bore në Brezovicë të shtunën në mesditë, e kanë përcjellë për në varrezat e qytetit qindra qytetarë dhe zyrtarë të lartë institucionalë. Në nderim të të ndjerit, krerët më të lartë të shtetit si dhe shumë qytetarë kanë bërë homazhe pranë arkivolit, në hollin e Kuvendit të Kosovës.



Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, pasi ka bërë homazhe pranë arkivolit të zëvendësministrit Daci, ka shkruar se kujtimi i mirë për Arianin do të jetë i përjetshëm. "Kujtimi i mirë për Arianin do të jetë i përjetshëm!", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Pas homazheve në hollin e Kuvendit, nën përkujdesjen e kryeministrit Ramush Haradinaj, është mbajtur edhe një mbledhje përkujtimore në Teatrin Kombëtar, ku bashkëpunëtorët e ngushtë e kanë vlerësuar lart personalitetin e të ndjerit.

Kryeministri Ramush Haradinaj ka deklaruar se Qeveria ka humbur një zyrtar të zellshëm. "Secilin fjalim të rastit sot e dominojnë lotët e pikëllimit dhe emocione të fuqishme të humbjes. Familja e nderuar e akademik Dacit e ka humbur birin e vetëm, Qeveria e vendit një zyrtar të zellshëm, kurse kolegët një mik të dashur. Prishtina humbi një djalë të ri, një qytetar të edukuar dhe shembullor", ka thënë kryeministri Haradinaj, duke shtuar se Ariani ka qenë një burrë i ndershëm që i ka shërbyer vendit. "Ariani ishte burrë i ndershëm, që e ka dashur këtë vend dhe i ka shërbyer me devotshmëri. Njerëzit si Arian Daci mbahen mend gjatë jo për zhurmë, por për qetësi dhe për mënyrën si i njohim, si jetojnë dhe si na ikin befasisht. Shpirti i bardhë i Arianit u nda nga ne me bardhësinë e borës. I bardhë ishte dhe, si të tillë, do ta mbajmë në mend përjetë", është shprehur Haradinaj.



Kurse ministri i Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Dardan Gashi, ka thënë se nuk ka fjalë për ta përshkruar dhimbjen për ndarje nga jeta të bashkëpunëtorit të vet. "Ky fjalim është më i rëndi gjatë gjithë karrierës sime. Nuk ka fjalë që përshkruajnë dhimbjen që po kalojmë nga kjo tragjedi. Nuk po mund të besoj që këto fjalë janë ngushëlluese dhe përshëndetje me Arianin", është shprehur ai, duke shtuar jo vetëm që ka qenë dora e djathtë e ministrisë, por edhe një mik i mirë.

Ndërsa në emër të familjes Daci ka folur Edi Daci-Prapashtica, motra e të ndjerit, e cila ka falënderuar të pranishmit për përkrahjen, ngushëllimet dhe praninë në këtë mbledhje përkujtimore. Përveç nga liderët institucionalë të Kosovës, familja Daci ka marrë telegrame ngushëllimi edhe nga krerët institucionalë të Shqipërisë: presidenti Ilir Meta dhe kryeministri Edi Rama; nga përfaqësuesit e shqiptarëve të Maqedonisë, si dhe përfaqësuesit e shqiptarëve të Luginës së Preshevës. Gjithashtu, familja Daci është ngushëlluar nga subjektet politike dhe institucione të ndryshme vendore.

Arian Daci ka qenë biri i vetëm i kryetarit të Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Nexhat Daci. Derisa ishte duke skijuar të shtunën jashtë pistës së skijimit në Brezovicë, Arian Daci është goditur për vdekje nga një ortek bore. Së bashku me Dacin ishte edhe një shok i tij, i cili i ka mbijetuar goditjes së ortekut. Ai kishte lindur në vitin 1979, ndërsa pas vetes ka lënë gruan dhe dy djem. Ariani ishte i shkolluar për farmaci, por kishte punuar për një kohë në një kompani të sigurimeve. Ai ishte emëruar në këtë mandat zëvendësministër i Diasporës në Qeverinë e Kosovës.

## Arian Daci kujtohet në mënyrë të veçantë

Ditën që është varrosur në varrezat e kryeqytetit, në lagjen Arbëria, zëvendësministri i Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike, Arian Daci, është kujtuar në mënyrë të veçantë nga disa studentë të Edukimit Fizik dhe Sportit. Duke i shprehur ngushëllime familjes, studentët me trupat e tyre kanë formuar emrin e të ndjerit në vendin ku ai ka vdekur.



Flet për "Epokën e re", Rashit Qalaj

# Objektivi i policisë, luftimi

Drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, ka bërë me dije se janë marrë një sërë masash për parandalimin e vjedhjeve dhe plaçkitjeve. Ai ka thënë se policia është duke identifikuar kryerësit e këtyre veprave penale dhe së shpejti do t'i sjellë para drejtësisë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Qalaj ka thënë se luftimi i krimit dhe korrupsionit është objektivi kryesori i policisë. Sipas tij, luftimi i krimit dhe korrupsionit duhet të bëhet për të ardhmen e vendit dhe jo për shkak të liberalizimit të vizave dhe integrimeve evropiane. Qalaj ka kërkuar ndihmën e institucioneve që Policia e Kosovës të bëhet sa më shpejt me sigurim shëndetësor dhe sigurim jetësor. Ai ka bërë me dije se Policia e Kosovës edhe këtë vit do të bëjë përpjekje për t'u anëtarësuar në Interpol




EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 27 JANAR -

**"Epoka e re":** *Z. Qalaj, kohët e fundit janë shtuar vjedhjet dhe plaçkitjet, madje si pasojë e tyre ka pasur edhe viktima. Çfarë masash po ndërmerrni për t'i parandaluar këto dukuri?*

Qalaj: Muaji dhjetor ka qenë i ngarkuar me një numër të madh të grabitjeve në nivel vendi, sidomos në Prishtinë. Fatkeqësisht, në njërën rast ka pasur edhe viktima, një zyrtar policor dhe një kryes i veprës penale kanë humbur jetën. Ky është dëm i madh për shtetin dhe popullin e Kosovës. Në disa incidente të tjera ka pasur edhe shkëmbim zjarri në mes të kryerësve të veprave penale dhe policisë, por nuk ka pasur pasoja në njerëz, mirëpo janë dëmtuar bizneset e ndryshme dhe institucionet mikrofinanciare. Policia është duke bërë të pamundurën që këto dukuri t'i parandalojë. Kemi pasur shumë aktivitete policore, me ç'rast një numër i madh i grabitësve janë arrestuar. Gjatë këtij muaji ka pasur numër më të vogël të grabitjeve në nivel vendi sepse janë shtuar aktivitetet policore, përveç njësive të rendit, janë angazhuar edhe njësitë speciale dhe të reagimit të shpejtë, ku ka pasur arrestime në disa komuna. Është shqetësuese kur dikush të hyjë në shtëpi, madje edhe me maskë dhe, përveç dëmit material, dëmi më i madh është frika që shkaktohet tek anëtarët e familjes apo edhe te punëtorët e bizneseve. Prandaj jemi duke bërë të pamundurën që t'i mbulojmë sa të mundemi akset rrugore dhe lokacionet afër dyqaneve. Jemi duke operuar afër bankave, mirëpo në pakufi fizikisht nuk mund t'i mbulojmë ato, por po bëjmë përpjekje që t'i identifikojmë personat që po i kryejnë këto vepra dhe t'i dërgojmë para drejtësisë.

**"Epoka e re":** *Jo të gjithë kryerësit e këtyre veprave po arrestohen, disa prej tyre kanë dalë jashtë vendi dhe po bëjnë 'hajgare' me policinë.*

**Qalaj:** Policia është në operim e sipër për t'i kapur ata. Mund të ketë vonesa, por drejtësisë nuk mund t'i ikësh. Them me përgjegjësi të plotë se ata shumë shpejt do të arrestohen. Çdokush që kryen vepra penale nuk mund të fshihet në asnjë vend sepse kudo që shkon, policia vepron, prandaj shumë shpejt do të arrestohen nga policitë në vendet ku ndodhen.

**"Epoka e re":** *Duhet të rritet lartësia e dënimit për vjedhje e grabitje në mënyrë që të zvogëlohet numri i këtyre veprave?*

**Qalaj:** Në Kodin Penal është përcaktuar ndëshkimi dhe lartësia e dënimit me burg. Policia i arreston, por është në autoritetin e gjyqtarit që ta përcaktojë lartësinë e dënimit. Natyrisht se lartësia e dënimit mund të ndikojë meqë çdokush kur planifikon të bëjë diçka e llogaritë edhe koston. Në këtë rast secili që planifikon të kryejë ndonjë vepër të kundërligjshme paraprakisht do t'i llogaritë pasojat që mund t'i ketë.

**"Epoka e re":** *Këto zhvillime kanë krijuar ndjenjën e pasigurisë?*

**Qalaj:** Në Kosovë ka siguri, mirëpo në çdo shoqëri demokratike ka individë që kryejnë vepra të ngjashme. Nëse e analizojmë situatën e sigurisë në rajon, Kosova është shumë më e sigurt në të gjitha aspektet sesa vendet përreth. Ju e shihni se çfarë ndodh brenda 24 orëve në vendet fqinje. Fatmirësisht, nuk kemi vepra të vrasjeve të rënda siç ndodhin në Shqipëri, Serbi etj. Megjithatë, për Kosovën janë shqetësuese këto vepra penale që po ndodhin, mirëpo besoj se në të ardhmen do të jemi edhe më të suksesshëm që t'i parandalojmë. Madje situata veç ka filluar të përmirësohet.

**"Epoka e re":** *Vendimi për legalizimin e armëve do të mund të ndikojë në rritjen e sigurisë, ndonëse deri më tani vetëm 208 qytetarë kanë aplikuar për t'i legalizuar armët?*

**Qalaj:** Ky vendim është shumë i rëndësishëm dhe i qëlluar por, fatkeqësisht, nuk ka përgjigje adekuate nga qytetarët. Është me rëndësi që numri i armëve që është në posedim të qytetarëve të jetë i kontrolluar. Mirëpo ende mungon vetëdija në shoqërinë tonë për t'i legalizuar armët.

**"Epoka e re":** *Shqetësuese vazhdon të mbetet edhe siguria në trafik dhe në këtë drejtim nuk po kanë efekt as gjobat e larta.*

**Qalaj:** Është fakt se gjendja në trafik është shumë shqetësuese. Nga paslufta ka pasur shumë viktima në rrugët e Kosovës dhe, për fat të keq, ky trend është duke vazhduar. Vetëm me gjobitje nuk mund të arrihet rezultati i dëshiruar, ndonëse ka rezultat. Çështjen e trafikut duhet ta analizojmë si tërësi dhe duhet të angazhohemi si institucione. Në kuadër të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit është formuar një Këshill Shtetëror për Sigurinë në Komunikacion dhe ky projekt do të fillojë të implementohet shumë shpejt në të gjitha rrugët kryesore të vendit. Ndër të tjera, do të bëhet edhe vendosja e kamerave me blic që do të masin shpejtësinë, sinjalistika do të përmirësohet, si dhe do të ketë shtim të patrullimit të policisë. Ka nevojë të forcohet regjimi i marrjes së patentëshoferëve si dhe të forcohet regjimi i kontrolleve teknike të automjeteve, në mënyrë që ta kemi gjendjen më të mirë të sigurisë në trafik. Duhet të fokusohemi edhe te përdorimi i telefonave dhe vendosja e rripit të sigurisë. Rrugët i kemi shumë më të mira sesa në të kaluarën dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit do të bëjë përmirësime të sinjalizimit vertikal dhe horizontal. Por, duhet të punojmë edhe për edukimin e qytetarëve nëpër shkolla meqë numri më i madh i të vdekurve janë këmbësorët. Këmbësorët duhet të jenë të kujdesshëm në vendet ku parashihet kalimi i tyre. Trafiku është një kaos i vërtetë, por të gjitha institucionet duhet të angazhohemi për ta përmirësuar gjendjen. Gjithashtu, duhet të organizohen fushata vetëdijësuese në vazhdimësi.

**"Epoka e re":** *Policia e Kosovës edhe më tutje vazhdon të mos ketë sigurim shëndetësor dhe jetësor. Kush po e pengon këtë proces?*

**Qalaj:** Kjo çështje është debatuar shumë, por është zotim i Qeverisë që Policia e Kosovës të ketë sigurim shëndetësor. Sipas informatave, shërbimi shëndetësor vetëm për policinë nuk mund të bëhet, meqë është në sistem dhe duhet të rregullohet për të gjithë. Duke pasur parasysh natyrën e punës dhe rrezikun me të cilin ballafaqohet policia, është shumë e rëndësishme që të ketë sigurim shëndetësor dhe sigurim jetësor. Prandaj do të ishte mirë që Policia e Kosovës qysh sot ta ketë sigurimin shëndetësor dhe sigurimin jetësor. Kjo nuk varet nga ne, por ka implikime buxhetore. Megjithatë, do të bëj përpjekje që t'i bind vendimmarrësit që të bëjnë sa më shpejt sigurimin shëndetësor dhe jetësor për policinë.

**"Epoka e re":** *Si po ecën procesi i rekrutimit të policëve të rinj të cilët po e ndjekin trajnimin në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike?*

**Qalaj:** Të premten që lamë pas i

# i krimit dhe korrupsionit



kam vizituar kadetët e rinj nga të cilët kam kërkuar të angazhohen për përmbushjen e kërkesave të instruktorëve trajnues. Qëndrimi i tyre në akademi do të jetë i vështirë sepse ata duhet të forcohen dhe kaliten në mënyrë që nesër kur të dalin në terren të jenë të përgatitur për t'i shërbyer vendit. Unë u emocionova kur i pashë dhe është fat i madh që kemi një rini të mirë dhe të interesuar për të punuar në Policinë e Kosovës. Kemi pasur një proces të rekrutimit me integritet shumë të lartë. Planifikojmë që pas ardhjes së kësaj gjenerate nga Akademia Policore do ta dërgojmë edhe gjeneratën tjetër me 400 kadetë. Për këtë vit planifikojmë t'i trajnojmë 800 kadetë që do të jetë një përfshirje e mirë për policinë dhe në mbështetje për një ambient sa më të qetë. Ardhja e kësaj gjenerate do ta zbuste shumë situatën sa i përket personelit në Policinë e Kosovës. Edhe gjenerata tjetër do ta kompletojë policinë sa iu përket burimeve njerëzore. Nëse kemi fat që Ligji për pensionim të parakohshëm të kalojë në Qeveri dhe Kuvend, e tërë lista në pritje do të absorbohet meqë do të kemi nevoja shtesë.

**"Epoka e re":** *Keni marrë premtime se do të miratohet shpejt ky ligj dhe a keni shifër sa policë do të pensionohen?*

**Qalaj:** Aktualisht nuk e kam shifrën. Jemi të interesuar që Ligji për pension të parakohshëm të kalojë pa implikime të mëdha buxhetore. Ky ligj duhet të implementohet në disa faza, pra për dy, tri, katër apo pesë vjet. Besoj se do ta gjejmë një zgjidhje. Ministri i Financave që kujdeset për kuletën e shtetit jo që nuk ka dëshirë ta mbështesë këtë proces, mirëpo ka implikime të mëdha buxhetore. Për këtë arsye duhet të gjejmë një modalitet që ligji të kalojë, por të mos jetë barrë e madhe e buxhetit. Jemi të interesuar që implementimi i këtij ligji të bëhet gradualisht në mënyrë që t'i zëvendësojmë kolegët që pensionohen.

**"Epoka e re":** *Jeni i kënaqur me bashkëpunimin në mes të institucioneve të sigurisë brenda dhe jashtë vendit?*

**Qalaj:** Bashkëpunojmë mjaft mirë me FSK-në, AKI-në dhe me partnerët ndërkombëtarë. Kemi bashkëpunim të shkëlqyer me policinë shqiptare dhe jemi në rrugë të mirë për bashkëpunim edhe me policinë maqedonase. Së shpejti do ta kemi një ushtrim të përbashkët të njësive speciale të Policisë së Kosovës, njësive speciale të Policisë së Maqedonisë dhe njësive speciale të Policisë së Shqipërisë në Shkup. Ende jemi duke punuar për skenarin e ushtrimit, por është hera e parë që këto tri polici do të ushtrojnë bashkërisht. Ushtrimet do të vazhdojnë në Shqipëri, në Kosovë dhe synojmë ta inkuadrojmë edhe Policinë e Malit të Zi në mënyrë që ta rrisim bashkëpunimin rajonal.

**"Epoka e re":** *Pavarësisht prej pritjeve, Kosova nuk arriti të bëhet pjesë e Interpolit. Do të ketë aplikim edhe këtë vit?*

**Qalaj:** Jemi në fazën finale për të vendosur për të aplikuar apo jo. Aplikimi duhet të bëhet deri në fund të muajit janar. Policia e Kosovës nuk është anëtare e Interpolit jo për shkak të profesionalizimit, por për arsye gjeopolitike dhe të lobimit të Serbisë e aleatëve të saj. Sa më shpejt që është e mundur duhet të jemi pjesë e Interpolit. Nuk është vetëm interes i Policisë së Kosovës, por interes i vet Interpolit. Kam dëgjuar një deklaratë të zëvendëskryeministri se Kosova do të aplikojë këtë vit për anëtarësim në Interpol. Jemi duke e bërë një analizë të brendshme dhe është në rregull që të aplikojmë.

**"Epoka e re":** *Cili do të jetë prioriteti kryesor për këtë vit?*

**Qalaj:** Kosova ka ligje të mira, ndoshta më të mirat në rajon. Ndryshimet në Kodin Penal u mundësojnë policisë, prokurorisë dhe gjyqësisë t'i luftojnë krimin e organizuar dhe korrupsionin. Ky është objektivi kryesor i policisë dhe organeve të tjera të rendit sepse e ardhmja e vendit varet nga luftimi i krimit dhe korrupsionit. Fokusi ynë do të jetë luftimi i korrupsionit, i krimit të organizuar, krimit kibernetik, ekstremizmit dhe terrorizmit. Prej se kam ardhur në krye të Policisë së Kosovës kemi arrestuar një numër të madh të zyrtarëve nëpër të gjitha nivelet, pra zëvendësministra, inspektorë të ATK-së, personel të Ministrisë së Shëndetësisë. Do të jemi të pamëshirshëm dhe nuk do të bëjmë dallim. Kudo që kemi fakte do të veprojmë. Do t'i luftojmë krimin dhe korrupsionin për të ardhmen e vendit, e jo për shkak të liberalizimit të vizave dhe integrimeve evropiane.

# Sondazh: Rreth 43 për qind e qytetarëve nuk e përkrahin grevën e SBAShK-ut

PRISHTINË, 27 JANAR - Me qëllim të matjes së perceptimit të qytetarëve, "Pyper" ka realizuar një sondazh lidhur me grevën në arsim. Në këtë sondazh kanë marrë pjesë 1 100 respondentë nga 29 komunat e Kosovës. Sipas rezultateve të këtij sondazhi, 42.78 për qind e respodentëve nuk e përkrahin grevën e mësimdhënësve, 27.79 për qind e tyre janë shprehur se e përkrahin pjesërisht, ndërsa 29.43 për qind prej tyre e kanë përkrahur plotësisht grevën për rritje të pagave.
Greva në arsim tashme ka hyrë në javën e tretë. Kryetari i Sindikatës së Bashkuar për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (SBAShK), Rrahman Jasharaj, ka thënë se ende nuk është arritur ndonjë marrëveshje për plotësimin e kërkesës së plotë të tyre.
Mësimdhënësit vazhdojnë të jenë këmbëngulës për realizmin e kërkesës së tyre që ka të bëjë me rritjen e koeficientit të pagës për 30 për qind.
Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë pas një takimi me SBAShK-un, se oferta e Qeverisë është 20 milionë euro më shumë për sektorin e arsimit dhe, sipas tij, "do të ishte një mashtrim nëse grevistët mendojnë se do ta kenë një ofertë tjetër". Më shumë se 350 mijë nxënës të institucioneve të arsimit parauniversitar dhe rreth 110 mijë studentë në Kosovë po hyjnë në javën e tretë të mosvijimit të procesit mësimor si rrjedhojë e grevës së mësimdhënësve.




# Shënohet Dita e Holokaustit në Prishtinë

PRISHTINË, 27 JANAR (ER) - Në Prishtinë, nëpërmjet një marshi të organizuar, u përkujtua të dielën Dita e Holokaustit, që shënon ditën kur forcat sovjetike e çliruan kampin Aushvic-Birkenau në vitin 1945. Gjatë Luftës së Dytë Botërore shumë shqiptarë në Kosovë e Shqipëri strehuan dhe mbrojtën hebrenj. Denis Galushi, organizator i marshit, ka thënë se viktimat do të përkujtohen gjithmonë, jo vetëm si statistikë. "Sot ne duam t'u tregojmë të tjerëve se 1.5 milionë viktima, jozyrtarisht thuhet se gjysmëmilioni ishin romë, kanë duruar gjenocidin. Prandaj është me rëndësi që sot, secili rom, të shndërrohet në institucion edukativ dhe t'u tregojë të tjerëve për këtë datë të rëndësishme", ka thënë Galushi.
Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka përkujtuar holokaustin, njërin prej tmerreve më të mëdha në historinë e njerëzimit. Thaçi ka thënë se shqiptarët duhet të ndihen krenarë për rolin që kanë luajtur për shpëtimin e hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore. "Sot kujtojmë një prej tmerreve më të mëdha në historinë e njerëzimit, holokaustin, që mori jetët e miliona civilëve vetëm për shkak të përkatësisë së tyre etnike. I kujtojmë dhimbjet që i mësuam nga dëshmitarët, duke u munduar të nxjerrim mësime rreth shkaktarëve të kësaj mizorie, për të mos lejuar që të përsëritet më për asnjë popull. Botës i janë dashur dekada të tëra që të përballet me peshën e krimeve të holokaustit dhe me përgjegjësinë e atyre që nuk e ndaluan një tragjedi të tillë. Prandaj angazhohemi për barazi, sundim të ligjit, liri dhe të drejta të barabarta për të gjithë. Si shqiptarë, ndihemi krenarë me rolin që kemi luajtur për shpëtimin e hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".




Edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, është shprehur krenar për ndihmën që populli i Kosovës ua ka ofruar qindra familjeve hebreje në kohën e persekutimit. "Në ditën e përkujtimit ndërkombëtar të holokaustit, Kosova nderon kujtimin e miliona viktimave të ideologjisë naziste. Njëkohësisht kujtojmë burrat dhe gratë e kombit tonë që gjetën forcë e guxim për t'i mbrojtur qindra familje hebreje nga persekutimi nazist. Ne ndihemi krenarë që jemi pasardhës të këtyre heronjve të solidaritetit dhe shpresës njerëzore. Ne jemi krenarë me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, e cila është lëvizja e fundit antifashiste në historinë evropiane të shekullit XX", ka thënë Veseli.
Edhe kryeministri Ramush Haradinaj ka përkujtuar të dielën Ditën Ndërkombëtare të Holokaustit. Me këtë rast, ai ka thënë se paraardhësit tanë na kanë bërë të ndihemi faqebardhë për shkak të shpejtimit të shumë hebrenjve. "Në Ditën Ndërkombëtare të Holokaustit reflektojmë për tragjedinë e madhe njerëzore dhe kujtojmë me përulje vuajtjet e një populli, të ngjashëm me shqiptarët për nga fati, që ua përcaktoi historia. Me strehimin dhe shpëtimin e hebrenjve, paraardhësit tanë edhe sot na bëjnë të ndihemi faqebardhë!", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook". Vlerësohet se afro 1.5 milion hebrenj evropianë janë vrarë përgjatë holokaustit së bashku me 4.5 milionë hebrenj të tjerë, përfshirë meshkuj dhe gra.

## Shërbyesit civilë paralajmërojnë grevë

PRISHTINË, 27 JANAR - Shërbyesit civilë nga dita e martë mund të hyjnë në grevë nëse nuk plotësohen dy kërkesat e tyre që i kanë dorëzuar Qeverisë së Kosovës. Lajmin e ka bërë me dije për "Radion Evropa e Lirë", kryetari i Sindikatës së Pavarur të Administratës së Kosovës, Ndue Kalaj, duke shtuar se të hënën presin reflektim nga ana e Qeverisë në mënyrë që greva të mos fillojë. "Kërkesa e parë është që shërbyesit civilë të jenë të barabartë, me koeficientin punë e njëjtë pagë e njëjtë, mos të ketë diskriminim. Ne e kemi parë në Shtojcën 1 të Ligjit mbi pagat, që është në kundërshtim me parimet themelore të përcaktuara për përcaktimin e pagës. Kërkesa e dytë është që shërbyesit civilë në vitet e '90-ta jemi të larguar nga puna prej regjimit serb dhe neve nuk na është pranuar stazhi përkundër rekomandimit të Avokatit të Popullit se nënpunësit e viteve të '90-ta janë dëbuar dhunshëm nga puna", ka thënë Kalaj, duke shtuar se greva planifikohet të fillojë të martën në nivelin qendror dhe lokal nëse Qeveria nuk ndërmerr masa konkrete.



Lëvizja Vetëvendosje ka mbajtur mbledhjen e radhës të Këshillit të Përgjithshëm

# Kurti paralajmëron protesta



Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka bërë me dije të dielën se mund të organizojnë protesta nëse tentohet të nënshkruhet ndonjë marrëveshje e dëmshme për Kosovën në fazën finale të dialogut. Në mbledhjen e radhës të Këshillit të Përgjithshëm të LV-së, ai ka thënë se qytetarët do t'i ndalin marrëveshjet e dëmshme për Kosovën

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 27 JANAR - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka paralajmëruar protesta të mëdha nëse në fazën finale të dialogut Kosovë - Serbi do të nënshkruhet ndonjë marrëveshje që prekë territorin e Kosovës. Të dielën, në mbledhjen e radhës të Këshillit të Përgjithshëm të Lëvizjes Vetëvendosje, teksa ka përmendur protestën e shtatorit të vitit të kaluar, ai ka thënë se nëse është nevoja, protesta e ardhshme do të jetë edhe më e madhe. "Vendosa ta përmend sot protestën e 29 shtatorit, sepse presidenti Thaçi dhe njerëzit e tij po këmbëngulin në pazaret me territor. Le ta dinë se, nëse përpiqen të na vendosin para aktit apo faktit të kryer me ndonjë marrëveshje që prek territorin e Kosovës, protesta jo vetëm se do të përsëritet, por do të jetë edhe më e madhe. Shumë më e madhe", ka thënë Kurti.

Në fjalën e tij ai ka kritikuar Qeverinë për paaftësi dhe për nisjen e procedurës për ta privatizuar Telekomin e Kosovës. "E ndërkohë që paaftësia e tyre në të shkuarën po prodhon lajme të këqija sot, ata nuk po harrojnë të vazhdojnë në të njëjtën rrugë. Tash po përpiqen të privatizojnë Telekomin e Kosovës, një ndërmarrje e cila vazhdimisht del me fitim, po të mos ishte duke u vjedhur prej partive në pushtet e kontratave të dëmshme sikurse ajo me Z-Mobile, e të cilat parti e kanë mbushur me punëtorë përtej nevojës, vetëm për të siguruar vota nga qytetarët e për t'i rehatuar militantët e tyre", ka thënë ai.

Kurti ka vlerësuar se gjendja ekonomike për secilën familje në Kosovë po bëhet shumë e rëndë derisa, sipas tij, qeveritarët privatizues e të korruptuar po jetojnë në luks. Në adresimin e tij, Kurti ka folur edhe për grevat që po ndodhin në sektorin publik. "Varfëria jonë po shndërrohet në greva. Sepse as mësuesit, as mjekët e askush nuk mund të durojë që qeveria t'ia rrisë rrogat vetes që nuk punon, por nuk ua rrit atyre që vërtet punojnë. Sigurisht, ne nuk duam që mësuesit e mjekët ta ndërpresin punën, sepse nxënësit kanë nevojë për mësim dhe të sëmurët për shërim. Por ne e kuptojmë thellësisht gjendjen e vështirë të atyre që punojnë në administratë publike, e sidomos të mjekëve e të mësuesve", është shprehur ai.

Në këtë situatë të vështirë, sipas Kurtit, ka edhe lajme të mira. "Vetëvendosja po rritet dhe, me këtë trend, shumë shpejt do të jetë parti e parë. Keqqeverisja do të marrë fund. Padrejtësitë do t'i luftojmë. Pabarazinë do ta zvogëlojmë. Kriminelët do t'i ndalojmë. Do ta zhvillojmë ekonominë e prodhimin. Do ta rrisim mirëqenien e punësimin. Do ta përmirësojmë shëndetësinë e arsimin. Qytetarët e dinë këtë, prandaj po anëtarësohen dhe po angazhohen në numra të mëdhenj në Vetëvendosje", ka thënë lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti.

# Thaçi: Në ditët e ardhshme institucionet do të marrin vendime në interes të shtetit



PRISHTINË, 27 JANAR (ER) - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka bërë me dije të dielën se në ditët e ardhshme institucionet shtetërore do të ndërmarrin veprime dhe vendime të cilat do të jenë në interes të forcimit të partneritetit me aleatët ndërkombëtarë. Ai ka thënë se të gjitha institucionet e Kosovës janë në shërbim të mbrojtjes dhe avancimit të interesave strategjike të vendit. "Në ditët dhe javët në vazhdim institucionet e Republikës së Kosovës do të ndërmarrin veprime dhe vendime në interes shtetëror dhe të forcimit të partneritetit me aleatët tanë ndërkombëtarë. Të gjitha institucionet shtetërore janë në shërbim të mbrojtjes, avancimit dhe arritjes së qëllimeve tona strategjike shtetërore", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Presidenti ka thënë se dialogu dhe marrëveshja eventuale paqësore me Serbinë vetëm sa e përshpejtojnë realizimin e synimeve të Kosovës për anëtarësim në BE, NATO dhe OKB. "Këto synime janë të arritshme për aq kohë sa jemi të bashkuar, pozitë, opozitë dhe shoqëri civile, flasim fuqishëm njëzëri dhe kemi mbështetjen e aleatëve tanë ndërkombëtarë, respektivisht mbështetjen e ShBA-së", ka thënë Thaçi.

Javën e kaluar Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Prishtinë ka kërkuar pezullimin e menjëhershëm të taksës ndaj Serbisë. Në një deklaratë për medie kjo ambasadë ka vlerësuar se pezullimi i kësaj takse është një masë e nevojshme për ta rimëkëmbur momentumin në procesin e dialogut. Sipas ShBA-së, pengesat nga anash dhe refuzimi për t'i pezulluar tarifat janë kundër interesave të ShBA-së.

# Haradinaj nuk tërhiqet nga taksa edhe pas thirrjes së ShBA-së




PRISHTINË, 27 JANAR - Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, ka folur sërish për tarifën 100 përqindësh ndaj mallrave serbe duke përsëritur se pa njohjen e Kosovës nga Serbia edhe tarifa nuk do të shfuqizohet. "Nëse në Beograd thonë që kurrë nuk ju njohim, edhe ne nuk mund të përdorim fjalë tjetër. Nëse ai thotë se kurrë nuk ju njoh. edhe ne mund të themi se kurrë nuk e heqim taksën", ka thënë Haradinaj gjatë një takimi me Degën e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) në Ferizaj.

Deklarata e kryeministrit Ramush Haradinaj vjen pas një komunikate të lëshuar nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara ku, përveç të tjerash, ritheksohet pikëpamja se një pezullim i menjëhershëm i tarifës në importet nga Serbia dhe Bosnja është një masë e nevojshme për ta rimëkëmbur momentumin në procesin e dialogut. "Veprimet që minojnë dialogun, pengesat nga anash dhe refuzimi për t'i pezulluar tarifat, gjitha këto shkojnë kundër interesave të ShBA-së", thuhet në komunikatë.

Qeveria e Kosovës më 6 nëntor të vitit të kaluar fillimisht kishte vendosur tarifë doganore 10 për qind për produktet e importuara me origjinë nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina. Kjo tarifë doganore u ngre në 100 për qind më 21 nëntor.

Përveç kësaj, më 28 dhjetor Qeveria e Kosovës ka marrë vendim të vendosë tarifë doganore 100 për qind edhe për produktet e importuara nga brendet ndërkombëtare që prodhohen në Serbi dhe Bosnje e Hercegovinë.




# Kosova do ta kryesojë për dy vjet Ditën Botërore të Pastrimit

PRISHTINË, 27 JANAR (ER) - Republika e Kosovës zyrtarisht ka marrë besimin e "Let's Do It World" për koordinimin dhe kryesimin e Ditës Botërore të Pastrimit. Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, në kuadër të vizitës zyrtare në Tallin të Estonisë, i është kumtuar lajmi se Republika e Kosovës do të jetë nikoqire e koordinimit dhe kryesimit të Ditës Botërore të Pastrimit për vitet 2019 dhe 2020. Me këtë rast, ministri Matoshi ka thënë se ndihet krenar me të arriturat e Kosovës në aksionin "Ta pastrojmë Kosovën", duke shprehur kështu se vendi ynë ka dhënë mesazh pozitiv në Tallinit të Estonisë për çështjen e mjedisit. "Kosova këtu ishte model për shumë vende të botës për angazhimin qytetar për përmirësimin e ambientit", ka thënë ministri Matoshi.

I pari i MMPH-së, Matoshi, ka falënderuar për angazhim të gjithë aktivistët, vullnetarët dhe qytetarët të cilët për tre muaj iu bashkuan aksionit "Ta pastrojmë Kosovën". "Urime drejtorit të Ditës Botërore të Pastrimit, z. Luan Hasanaj, gjithë stafit të Let's Do It Kosova dhe qytetarëve të Kosovës", ka thënë ministri Matoshi.

Dita Botërore e Pastrimit do të koordinohet dhe kryesohet nga Kosova duke filluar më 21 shtator 2019.

# Zonë ekonomike për joshjen e investitorëve amerikanë

**Prishtinë, 27 janar** - Përgatitjet për vënien në funksion të zonës ekonomike amerikane në Kosovë janë duke vazhduar, bëjnë me dije përfaqësues të Qeverisë së Kosovës. Lehtësirat ekonomike dhe infrastruktura që do të ketë kjo zonë ekonomike konsiderohet se do të tërheqë investime amerikane në vend.

Në qershor të vitit të kaluar Qeveria e Kosovës pati miratuar formimin e Zonës së Veçantë Ekonomike Amerikane, e cila ishte vendosur të jetë në Komunën e Gjakovës.

Haki Shatri, këshilltar për ekonomi i kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se janë duke punuar për vënien sa më të shpejtë në funksion të Zonës Ekonomike Amerikane. Infrastruktura për këtë Zonë Ekonomike Amerikane, shton Shatri, është në përgatitje e sipër. "Janë duke u bërë angazhime për funksionalizmin e Zonës Ekonomike Amerikane. Sa i përket Qeverisë janë duke u bërë diskutime që autostrada e re ajo e Dukagjinit t'i mundësojë qasje zonës ekonomike amerikane në këtë rrugë. Ministria e Infrastrukturës e ka marrë parasysh si obligim që t'i mundësojë qasje të përshtatshme në autostradë Zonës Ekonomike Amerikane", ka thënë Shatri.

Autostrada e re që pritet të lidhë qytetet Istog-Pejë-Deçan-Gjakovë dhe Prizren është paralajmëruar se do të nisë së ndërtuari gjatë këtij viti. Ajo llogaritet të jetë ndër autostradat më të gjata në territorin e Kosovës, me 91 kilometra.

Drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Arian Zeka, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se kjo Zonë Ekonomike Amerikane në Kosovë e vetmja e këtij lloji në rajon, pritet të tërheqë investitorë seriozë amerikanë të cilat do të shtrijnë kapitalin e tyre në Kosovë. "Kemi bërë një dokument më rekomandime tona sa i përket lehtësira të tjera që duhet të ofrohen brenda Zonës Ekonomike Amerikane, mënyrës së zhvillimit të saj dhe ajo çka është më e rëndësishmja, është mënyra e administrimit të saj në të ardhmen, pasi kjo është çështje thelbësore dhe e rëndësishme e zonës. Këto ia kemi dërguar dërguar Qeverisë. Lehtësirat që ne i kemi rekomanduar Qeverisë janë përtej lehtësirave që parashihen në ligje, janë lirimet për tatimet e ndryshme të cilat e tejkalojnë periudhën që ofrohen me legjislacionin aktual tatimor, pastaj lehtësira të tjera sa i përket tatimit në të ardhura personale që, po ashtu, tejkalon atë që ofrohet në legjislacionin tatimor. Sa i përket zhvillimit kemi dhënë rekomandime konkrete si duhet të zhvillohet Zona Ekonomike dhe, po ashtu, kemi dhënë edhe detaje teknike si, p. sh., organizimi i transportit publik për punonjësit dhe lehtësira të tjera", ka thënë Zeka.

Zona Ekonomike Amerikane në Kosovë, shton Zeka, tanimë vetëm u është prezantuar një numri të konsiderueshëm të bizneseve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. "Në Iowa të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në një takim me bizneset amerikane, anëtare të një asociacioni të madh të bizneseve, kam prezantuar rëndësinë e zonës dhe kjo ka ngjallur interesim nga ana e kompanive amerikane, por Zona Ekonomike duhet të vazhdojë. Duhet të shohim hapa konkretë për jetësimin e saj në mënyrë që investitorët që kanë ndonjë interesim të shohin se ajo realisht po ndodh", është shprehur Zeka.

Investitorët amerikanë dhe investitorët e tjerë ndërkombëtarë në vazhdimësi kanë theksuar se përballen me shumë burokraci në komunat e Kosovës. Investimet e huaja direkte në Kosovë nga viti në vit kanë shënuar rënie. Derisa në vitin 2007 shuma e investimeve të huaja ishte 440 milionë euro, në vitet e fundit vlera e investimeve të huaja mesatarisht arrin vlerën e rreth 250 milionë euro.



Reuters

## KOSTT-i certifikohet nga Energy Community Regulatory Board

**Prishtinë, 27 janar (ER)** - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka njoftuar se Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut të Energjisë në Kosovë (KOSTT) është certifikuar nga Energy Community Regulatory Board dhe tash e tutje do t'i njihen ndërkombëtarisht të gjitha asetet me të cilat disponon. Sipas Haradinajt, certifikimi nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë ka rëndësi për njohjen e KOSTT-it si operator i sistemit transmetues nga Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit Transmetues të Energjisë Elektrike si një ndër parakushtet themelore për anëtarësim në ENTSO-E dhe institucionet e tjera evropiane që do t'i mundësonte operim të pavarur nga Serbia. "Përgëzime për këtë lajm fantastik për Kosovën, stafit menaxhues të këtij mekanizmi të rëndësishëm si dhe qytetarëve të vendit. Kosova po ecën sigurt drejt pavarësisë së plotë dhe qëndrueshmërisë energjetike", ka thënë Haradinaj.



# Zgjidhet problemi me energji elektrike në Mitrovicë

MITROVICË, 27 JANAR (ER) - Tashmë e tërë Mitrovica ka energji elektrike, pasi është kyçur edhe linja e tretë e furnizimit për këtë qytet. Aktivizimi është arritur falë rifunksionalizimit të linjës që derivon nga një trafo e vjetër e Trepçës e cila ishte jashtë funksionit.
Ekipet e KEDS-it kanë kyçur lidhjen 35 kV, ekipet e KOSTT-it linjën 110 kV dhe Trepça ka ofruar trafon. Ky është opsioni i tretë brenda tri ditësh, pasi para tri ditësh si rezultat i një pune të jashtëzakonshme në Mitrovicë ishin krijuar dy linja furnizuese për këtë qytet dhe fshatrat përreth, duke përfshirë edhe Trepçën. Kjo ishte arritur falë 90 punëtorëve të KEDS-it dhe 30 punëtorëve të kontraktuar nga kompania të cilët kanë arritur në afat rekord ta krijojnë lidhjen e Mitrovicës si nga ana e Vushtrrisë, po ashtu edhe nga nënstacioni i Vallaqit në veri të vendit.





# Beqir Fejzullahu zgjedhet kryetar i Degës së PDK-së në Shtërpcë

SHTËRPCË, 27 JANAR (ER) - Në prani të delegatëve të nëndegëve të Degës së PDK-së në Shtërpcë është mbajtur Kuvendi Zgjedhor i Degës, ku me vota të fshehta është zgjedhur Këshilli Drejtues me 31 anëtarë dhe me katër delegatët për konventën e përgjithshme si dhe kryetari i degës, Beqir Fejzullahu.
"Dekada e Re" dhe vizioni i liderit të PDK-së, Kadri Veseli, kanë gjetur në mesin e anëtarëve të nëndegëve të Partisë Demokratike të Kosovës, optimizëm dhe gatishmëri për zbatimin e platformës dhe vizionit më optimal për secilin qytetar në dekadën që po vjen.
Kryetari i Degës së PDK-së në Shtërpcë u zgjodh aktivisti i mirënjohur i PDK-së, aktualisht zëvendësministër, Beqir Fejzullahu. "Procesi zgjedhor po ecën sipas planit, pa asnjë vërejtje, në pajtim me rregulloret dhe procedurat", ka bërë me dije anëtari për organizimin e zgjedhjeve të brendshme në PDK, Ilir Gashi. Ai ka shtuar se dinamika është e tillë që gjatë muajit mars të këtij viti pritet të finalizohet procesi i brendshëm zgjedhor me Konventën e Përgjithshme.
Këtë javë kuvendet e nëndegëve janë mbajtur në nëndegët: Fushë-Kosova 5, Mushtisht, Caravik, Zabërgjë, Istogu Qendra, Kastriot-Nëndega 2, Lugishtë-Has, Samadrxhë, Gjonaj, Gllarevë, Stapanicë, Rigjevë, Bujan, Dobërdolan, Lipjani-2, Fushë-Kosova-1, Kobajë dhe vazhdojnë tubimet zgjedhore gjithandej në nëndegët e PDK-së në tërë vendin.

# Inspektorët komunalë në Malishevë konfiskojnë grurë të krimbur



MALISHEVË, 27 JANAR (ER) - Pas një shqetësimi publik të një qytetari, i cili në rrjetet sociale kishte publikuar një video përmes së cilës tregonte se kishte blerë grurë të krimbur në marketin "Viva Fresh Store" në Malishevë, inspektorët komunalë kanë dalë të dielën në orët e para të mëngjesit dhe kanë inspektuar këtë market.
Inspektorët kanë hasur në produktin grurë i qëruar "Duru", i cili ishte i krimbur.
Sipas drejtorit të Drejtorisë së Inspektoratit, Dibran Kastrati, i cili kishte asistuar në kontrollin e bërë, është gjetur një sasi e grurit të krimbur, ku pastaj sasia e gjetur është konfiskuar nga inspektorët komunalë. "Po ndaj marketit është shqiptuar edhe një gjobë mandatore dhe janë marrë të gjitha masat konform ligjit", ka thënë ai.
Drejtori Kastrati ka bërë me dije se informacioni është marrë nga një qytetar. Kastrati u ka bërë thirrje qytetarëve të bashkëpunojnë me inspektoratin me qëllim të ruajtjes së shëndetit të qytetarëve.

## Skenderaj nëpërmjet Arbnora Fejza-Idrizi bëhet pjesë e Librit "Guinness"

SKENDERAJ, 27 JANAR (ER) - Nën përkujdesjen e kryetarit të Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, është organizuar ceremonia e prezantimit të Certifikatës së Librit të Rekordeve Botërore "Guinness" për Arbnorë Fejza-Idrizi, e cila ka thyer rekordin botëror me punimin e lules origami, si lulja më e madhe në botë.
Kryetari Jashari në fjalimin e tij ka thënë se emri i qytetit të Skenderajt tashmë është i shkruar në Librin e Rekordeve Botërore "Guinness". Në këtë kontekst, ai ka thënë se ndihet krenar pas arritjes jetësore të Arbnora Fejza-Idrizi, e cila ka thyer rekordin botëror që e mbante Franca, të punimit të lules origami, si lulja më e madhe në botë. "Nuk kam si të mos ndihem i lumtur që jam kryetar i një komune të cilën bota sot e njeh nëpërmjet veprës së znj. Arbnorë. Sot kemi organizuar ceremoni zyrtare të prezantimit të Certifikatës nga Libri 'Guinness', ku i kemi nderuar me mirënjohje ekipin mbështetës të znj. Arbnorë dhe profesorët e saj me të cilët ka realizuar këtë vepër botërore. Mbështetja jonë për idetë kreative nuk do të mungojë edhe në të ardhmen. Faleminderit znj. Arbnorë që na bëtë krenar!", është shprehur kryetari Jashari.



Ndërsa Arbnora Fejza-Idrizi me këtë lule me diametër prej 8.7 metrash, ka mposhtur shtetin e Francës që mbante këtë rekord me lulen origami me diametër prej pesë metrash. Ajo është shprehur krenare që ka arritur ta shkruajë emrin e Kosovës në një libër të famshëm si "Guinness". Fejza-Idrizi ka thënë se qysh në fillim të projektit kishte gjetur përkrahje nga komuna e Skenderajt. Në fund të ceremonisë, gjatë së cilës është shfaqur dokumentari i punimit të lules origami, kryetari Jashari ka ndarë mirënjohje për ekipin mbështetës dhe profesorët e Arbnora Fejza-Idrizit.

# O njerëz, thirrini mendjes sa nuk është bërë tepër vonë!!!



Milazim KRASNIQI

Ideja e shkëmbimit/përshtatjes/korrigjimit/adoptimit të kufirit ndërmjet Serbisë e Kosovës është ide për zhbërjen e shtetit të Kosovës. Është konspiracion serbo-rus, i koordinuar edhe me lobistët e tyre në Perëndim. Ka shumë argumente për këtë gjë. Dy po i veçoj në këtë rast: 1. zdërhalljet nacionalfashiste të serbëve në Bujanoc, ku ata dhanë mesazhin e qartë për luftë. Aty u rikthye slogani i këngës, "Kush thotë, kush gënjen se Serbia është e vogël", me të cilin në vitet 90 patën filluar luftërat agresive të Serbisë kundër Sllovenisë, Kroacisë, Bosnjës e Kosovës. Nuk e di kush është aq idiot sa të mendojë se serbët e Bujanocit pranojnë të ndahen vullnetarisht nga Serbia e t'i bashkohen shtetit të pavarur të Kosovës? Në atë rast, ata do të ishin më idiotë, se sa idiotët që do t'ua imponónin një vendim të atillë! 2. Deklarata e Janush Bugajskit se Kosova mund të mashtrohet në negociata. Sipas tij, Rusia do ta shfrytëzonte lëvizjen kufijve për interesat e veta, e jo për stabilitetin në rajon. Po ashtu Bugajski pohon se askush nuk mund ta detyrojë Rusinë e Kinën që ta njohin Kosovën e ta lënë të pranohet në OKB. Pra, ata që e besojnë këtë përrallë, janë gjithsesi naivë.

Nga mozaiku i deritashëm, një gjë është e sigurt: nëse hyhet në procesin e shkëmbimeve të territoreve, Kosova fillimisht do të përfundojë në konflikte ndëretnike, pastaj në katastrofë humanitare e spastrim etnik dhe në fund në copëtim e zhbërje. Planet e Serbisë dhe Rusisë janë të qarta në këtë drejtim. Ideja e Vuçiqit për "kufi ndëretnik ndërmjet serbëve e shqiptarëve" parasheh zhdukjen nga harta të Kosovës si shtet, duke e copëtuar ndërmjet Serbisë e Shqipërisë. Ndërsa planet e Perëndimit ndaj Kosovës janë gjithnjë e më të paqarta, bile gjithnjë e më pak miqësore. Prandaj, në rast të fillimit të konflikteve të armatosura, që u paralajmëruan dje edhe në Bujanoc e përsëriten çdo ditë në veriun e Mitrovicës, Kosova nuk do të mbijetojë si shtet. Do të futeshin paramilitarë serbë e rusë, do të furnizoheshin me armatime dhe do të bënin vrasje masive e spastrim etnik. Kosovën do ta shndërronin në një tokë të djegur, ngjashëm me atë që ndodhi në Siri.

Në këtë mozaik duhet pasur para sysh edhe këtë zhvillim: ratifikimi i Marrëveshjes së Prespës nga Kuvendi i Maqedonisë dhe ai i Greqisë, faktikisht Maqedoninë e fut nën ombrellën e NATO-s. Kjo do të thotë se konflikti eventual në Kosovë, do të ishte i izoluar, gjë që e bën më të lehtë zbatimin e një skenari të zgjidhjes së kontestit ndërmjet Serbisë e Kosovës me një konflikt të armatosur, të kontrolluar. Pra, ndryshimi gjeopolitik që ka sjellë Marrëveshja e Prespës, për Kosovën, paradoksalisht, mund të jetë i disfavorshëm.

Duke i pasur para sysh këto zhvillime, është e qartë se është koha e fundit që të shmanget skenari i tmerrshëm i shkëmbimit të territoreve, i cili pashmangshëm shpie në konflikt, luftë e spastrim etnik. Prandaj, Qeveria, Kuvendi dhe mbarë populli i Kosovës, duhet të mobilizohen e ta parandalojnë rrezikun. Ne nuk duhet ta harrojmë faktin se ata që nuk e parandalojnë të keqen, e keqja i godet. Mandej merren me pasojat e saj, në vend se t'i shijojnë gëzimet e lirisë dhe të jetës.

# Zhgënjimi i rinisë

- Kombi pa rini, si familja pa fëmijë



Prof. Lisen BASHKURTI

Prej 45 vjetësh punoj me rininë. Puna me rininë është sfidë e madhe. Gjithnjë rinia tenton të jetë një hap përpara brezave të tjerë, pavarësisht nëse është e përgatitur dhe e qartë për këtë. Nga vetë mosha, rinia nuk preferon të përsiatet për të kaluarën, e cila për të nuk është objekt nostalgjie. Nga vetë mosha, rinia nuk e përjeton me shumë ngulmim të sotmen, pasi e konsideron shumë kalimtare. Rinia mban gjithë shqisat dhe mendjen tek e ardhmja.

Rinia mendon dhe ëndërron për një të ardhme jo shumë afatgjatë. Vizioni rinor për të ardhmen është dëshira e së nesërmes sepse në botën rinore, midis ideve, nevojave dhe dëshirave, këto të fundit janë dominuese.

Bazuar në këto tipare rinore kam vëzhguar me kujdes, përmes një metode të thjeshtë empirike, se si ndihet rinia shqiptare studentore sot në Shqipëri dhe Kosovë. Vëzhgimi me rezulton se ka rritje të zhgënjimit të rinisë lidhur me perspektivën zhvillimore të Shqipërisë dhe Kosovës. Zhgënjimi ka të bëjë me tensionet e tejzgjatura politike, varfërinë e pandryshueshme ekonomike, arsimimin pa destinacion në të ardhmen, jetën e vakët kulturore e shpirtërore.

Më shumë se gjysma e studentëve të pyetur nga unë me rezulton se do të largoheshin nga vendi pa qenë fare të qartë për të ardhmen jashtë, mjafton të lënë pas mërzitjen që i shkaktojnë situatat me kriza ciklike në Shqipëri dhe Kosovë. Kjo situatë rinore duket se nuk është sa dhe si duhet në agjendat e politikave tona. Shtetet, qeveritë tona, por edhe aktorët joshtetërorë duket se kanë çfarëdo lloj agjendash, por agjendën rinore e kanë vetëm në retorikë.

Nëse aktorët shtetërorë dhe joshtetërorë nuk do ta prioritizojnë seriozisht agjendën rinore me gjithë përmasat dhe dinamikën e saj shumë shpejt familjet shqiptare do të ngelen pa fëmijë dhe kombi shqiptar do të ngelet pa rini. Do të hynim në një fazë plakje jonatyrore siç po ndodh te shumë kombe të tjera, por në një fazë plakje të imponuar nga dështimet e politikave tona.

Apeloj tek të gjithë aktorët shtetërorë dhe joshtetërorë në Shqipëri dhe Kosovë t'i kthejnë qysh sot sytë kah rinia. Nesër do të jetë vonë... shumë vonë. Pa rininë kombi shqiptar do të humbiste një prej vlerave më të vyera që e ka mbajtur gjallë, e ka fuqizuar dhe e ka dalluar midis popujve e kombeve të tjera në Evropë.

# Burrështetësia e Ramush Haradinajt



Avni KLINAKU

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka përpara vetes një vendim tepër të rëndësishëm. Të rëndësishëm për të, për Kosovën dhe për krejt kombin. Ai sot përballet me drejtësinë e një çështjeje dhe fuqinë e tij e të Kosovës për ta mbrojtur këtë të drejtë. Natyrisht që të gjithë e dimë se është fjala për taksën ndaj prodhimeve serbe dhe kërkesën ultimative amerikane për ta hequr atë.

Heqja e taksës cenon drejtësinë, sovranitetin e interesin tonë; mbajtja e taksës cenon raportet me ShBA-në! Si të veprohet në këtë rast? Kjo është çështja! Edhe Ramushi, si të gjithë të tjerët, e di se tërheqja e taksës është e pashmangshme, por një tërheqje e parakohshme e Ramushit do ta shkatërronte atë; një vonesë do ta dëmtonte Kosovën dhe prapëseprapë do ta shkatërronte Ramushin! Një sfidë të tillë Ramush Haradinaj sikur e ka kërkuar gjatë gjithë periudhës së pasluftës. Ai gjithmonë ka dashur që ta dëshmoi veten edhe në paqe sikurse në luftë! Këtë sfidë Ramushi shumë shpesh është përpjekur ta krijoj e ta zgjidhë edhe përmes muskujve! Por sot ai e ka mundësinë që sfidën ta zgjidhë në tavolinë. Me vendim. E vendimi si kryeministër është vetëm i tij. Vetëm ai është i pajisur me të gjithë informacionin, si atë publik, po ashtu edhe atë të kanaleve diplomatike.

Të gjitha thirrjet të tipit "hiqe taksën se na more në qafë" ose "taksa nuk duhet të hiqet me asnjë çmim" janë shumë naive! Vendimi duhet të merret as herët e as vonë. Aftësia dhe detyra e një burrështetasi është ta gjejë këtë moment! Dhe kjo sot i takon vetëm Ramush Haradinajt!



# ISMAIL QEMALI, SH



Rexhep QOSJA

## - Një fund dhe një fillim

Këtë vit, 2019, e shënojmë 100-vjetorin e ndarjes nga jeta të Babait të Pavarësisë së Shqipërisë, Ismail Qemalit.
Ismail Qemali është personalitet me rëndësi të madhe në historinë e popullit shqiptar. Me emrin e tij është i lidhur një fund dhe një fillim në këtë histori: fundi i pushtimit shumëshekullor otoman dhe fillimi i lirisë dhe i pavarësisë shqiptare, sado jo për krejt popullin shqiptar.
Si themelues i Shqipërisë, ai hyn në radhën e atyre personaliteteve që e kanë ndryshuar historinë politike të popullit shqiptar dhe të Ballkanit në përgjithësi.

## Karakteri i tij

Ismail Qemali është një nga politikanët me prejardhje shqiptare më të suksesshëm në Perandorinë Otomane. Dhe, kur thuhet kështu, mendohet për karrierën e tij të gjatë politike e shtetare dhe për ndikimin e tij të madh. Ai i kishte tri parakushte për sukses politik dhe shtetëror: e para, kishte prejardhje fisnike - çka shikohej shumë në atë kohë; e dyta, ishte aq i pashëm e përshtypjelënës në mesin e burrave të tjerë - çka nuk ishte e parëndësishme as atëherë, as më vonë; e treta, ishte aq mendjelartë sa të shquhej fort mes të shquarve - çka çmohet shumë gjithmonë.
Cilësitë me të cilat e kishte dhuruar natyra apo ishte pajisur gjatë jetës e punës, më parë se ç'kundërshtoheshin, krijonin baraspeshë në personalitetin e tij. Ai ishte modest dhe i dinjitetshëm, i vendosur dhe zemërgjerë, i guximshëm dhe i matur, gojëtar e largpamës. Gjykimi i tij i qartë, sjellja e tij e avashtë dhe shija e tij e sigurt e bënin sipëror dhe magjepsës personalitetin e tij. Me veprimin e tij të njësuar, ai ishte zotëruesi i situatave dhe, siç është thënë bukur për të, zotëria i kohës.
Në pozitë të lartë a pa të, i pasur a i varfëruar, i adhuruar a i shpërfillur, i mbrojtur a i dënuar, në Atdhe a në mërgim, ai ishte kudo e kurdo Ismail Qemal Vlora.

## Karriera e tij

Në sajë të cilësive të sipërthëna, Ismail Qemali do të arrijë të bëhet denjëtar i lartë në Perandorinë Otomane.
Por, në sajë të cilësive të sipërthëna, Ismail Qemali do të arrijë të bëhet prijës i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, themelues i shtetit shqiptar dhe kryeministër i Shqipërisë - të gjitha këto aty ku, zakonisht, zogoritë e mediokriteteve ndiejnë kënaqësi të madhe në përmbysjen e gjenive!



Gjatë, gati gjysmëshekulli të veprimtarisë politike e shtetare në Perandorinë Otomane, ai do të arrijë të jetë sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme, por edhe i caktuar ministër i Jashtëm, ministër i Punëve të Brendshme a i Drejtësisë; prijës a pjesëmarrës në misione të ndryshme politike e diplomatike të Perandorisë në vende të Evropës; Kryetar i Komisionit Evropian të Danubit; këshilltar a sekretar i kryeqeveritarëve në vilajete; prefekt në qytete të mëdha a kryeqeveritar në krahina të mëdha të Perandorisë; kryetar i Dhomës së Deputetëve, por nuk e pranonte titullin pasha sepse e shihte si diçka të tejkaluar. Njohja e gjendjes politike e shoqërore dhe përvoja e madhe shtetare do ta bëjnë disa herë të përzgjedhurin e sulltanit për reforma shtetërore. Cilësitë e lartthekësuara do ta bëjnë, njëkohësisht, edhe të dyshimtin a të dënuarin e sulltanit, para të cilit ai do të ketë guximin t'i shfaqë shpengueshëm mendimet. Domethënë: cilësitë që do ta bëjnë të mundshme karrierën e tij, do të bëhen edhe shkaku i smirës, që do të zgjojë te politikanë e diplomatë dhe i përndjekjeve që do të pësojë, duke qenë i çuar në mërgim, i privuar pasurie dhe i dënuar me vdekje.

## Besimi i tij politik

Të dhënat që dihen për jetën dhe veprimtarinë politike e shtetare të Ismail Qemalit, kujtimet e tij dhe kujtimet e të tjerëve për të e kallëzojnë njeri me formim të gjithanshëm dhe me kulturë të gjerë, çfarë ishin shumica e intelektualëve shqiptarë të Rilindjes Kombëtare. Në mendjen e tij kishte vend për të gjitha kulturat, kurse në zemrën e tij vend për të gjitha racat, të gjitha kombësitë dhe të gjitha besimet.
Megjithëse atdhetar i përkushtuar dhe krijues i shtetit shqiptar, ai kurrë nuk do t'i keqpërdorë ndjenjat kombëtare për qëllime politike.
Megjithëse mysliman për nga besimi, ai do të kalojë jetë të lumtur me gruan e besimit të krishterë dhe të kombësisë tjetër.
Megjithëse politikan e diplomat në një Perandori në të cilën sundonte despotizmi oriental, me bindje e me sjellje ai ishte demokrat liberal. Marrëveshja ishte mjeti i tij politik; toleranca ishte mënyra e sjelljes së tij; humanizmi ishte etika e tij; liberalizmi ishte koncepti i tij për shtetin dhe shoqërinë.
Ai mbron të drejtat e njeriut në një kohë kur nuk kishte mbrojtje të tyre të ligjësuar dhe në kushte në të cilat aq shumë shkeleshin ato më shumë vende në Botë.
Ai punon për lirimin e çerkezëve që trajtoheshin skllevër; ai merret me vendosjen në Perandorinë Otomane të hebrenjve të dëbuar dhunshëm nga Rusia. Kudo është i caktuar për qeveritar në Perandori, Ismail Qemali bën përpjekje të asnjanësojë pasojat e sundimit despotik dhe të ushtrojë pushtetin si pushtet të ndërgjegjes.
Liberalizmi i Ismail Qemalit ka më shumë se një burim. Burimi i parë është shkollimi i tij. Në gjimnazin e njohur Zosimea të Janinës ai do të mësohet "të jetojë - si thotë vetë - në frymën e lirive të botës së vjetër greke" dhe do të përvetësojë ide liberale të Volterit, Rusos e Lokut.
Burimi i dytë janë njohuritë që kishte për Evropën Perëndimore. Ai qëndron shpesh, më shkurtër a më gjatë, në Angli, në Francë e në Itali, ku njeh organizimin shtetëror, sistemin ekonomik, filozofinë politike, qytetërimin e tyre.
Burimi i tretë i liberalizmit të Ismail Qemalit është kultura e tij politike dhe historike. Ai e di se vetëm shtetet demokratike janë shtete historikisht të qëndrueshme. Ai thekson se shovinizmi shtetëror, politik, kombëtar dhe fetar është varrtar i shteteve. Ai thekson se "çdo perandori që është krijuar me shpatë në të njëjtën kohë ka mbjellë edhe farën e shkatërrimit të vet". Për këtë arsye, për rregullimin shtetëror ai e çmon "forcën morale më të fuqishme se forcën e armatosur" por, natyrisht, forcën morale të mbështetur në ligje demokratike.

## Vepra e tij historike

Me bindje të tilla, liberale, të cilat ishin bërë shkaku i përndjekjes së tij, Ismail Qemali do të hyjë në Lëvizjen Kombëtare për krijimin e shtetit shqiptar. Por, bindjet që kishte dhe cilësitë me të cilat shquhej do ta bëjnë shpejt prijësin e kësaj Lëvizjeje. Si edhe ideologët e Rilindjes Kombëtare përpara tij, që kishin vdekur në mërgim, një kohë edhe ai do të mendojë për zgjidhjen e çështjes kombëtare përmes autonomisë në gjirin e Perandorisë Otomane, por të Perandorisë së shqendërzuar në federatë të kombeve. Do të mendojë kështu sepse e dinte se disa nga fuqitë e mëdha, e, sidomos, Britania e Madhe, ishin të interesuara që kjo perandori të mbahej si një nga faktorët për mbajtjen e baraspeshës së tyre. Evropa, ndërkaq, po i afrohej luftës botërore, kurse tronditjeve që do të sjellë ajo po u afrohej edhe Perandoria Otomane. Kur do të



bindet se kjo Perandori po përmbysej dhe se me përmbysjen e saj mund të përmbysej edhe shpresa e shqiptarëve për krijimin e shtetit të vet, kur do të bindet se fqinjët ballkanikë me luftë do t'i copëtonin tokat shqiptare, domethënë kur do të bindet se çasti historik për veprim të vendosur historik kishte ardhur, Ismail Qemali do të zëvendësojë idenë e autonomisë me idenë e pavarësisë së Shqipërisë. Njëkohësisht ai do të ndryshojë edhe idenë për mjetet që do të duhej të përdoreshin për sendërtimin e asaj pavarësie: në vend të luftës politike - si i vetmi mjet, ai tani do të kërkojë luftë të armatosur - si mjet kryesor. Rrjedhimisht, veprimtaria e tij përqendrohet: e para, në bashkimin e të gjitha forcave mendore, morale e vepruese kombëtare për atë luftë dhe, e dyta, në sigurimin e mirëkuptimit të Fuqive të Mëdha për kërkesën shqiptare. Sikundër shihet, formulës së tij politike gjithnjë realiste, Ismail Qemali tani do t'ia shtojë edhe përbërësin idealist. Gjeniu i tij politik e çmon se ajo më e dëshiruara, ajo e mundshmja, tani ka mundësinë të bëhet e sendërtueshme. Dhe, më 28

# EMBULLI HISTORIK



nëntor 1912 ai mbledh në Vlorë Kuvendin Kombëtar, i cili shpall pavarësinë e Shqipërisë, i cili zgjedh Qeverinë e Përkohshme dhe i cili e zgjedh Atë, Ismail Qemalin, kryeministër të saj.
Ky ishte shtet ende pa kufij, pa forca të rendit, pa ushtri, pa administratë kombëtare, pa ekonomi, pa financa - shtet pa kushte shteti. Por, ky shtet i porsalindur, megjithatë, kishte dinjitetin politik, juridik dhe moral të shtetit: institucionet e tij shtetformuese - Kuvendi dhe Qeveria, ishin sovrane në një pjesë, sado e vogël qoftë ajo atëherë, të Shqipërisë së ardhshme. Qeveria e Përkohshme, me në krye Ismail Qemalin, liberalin që ishte i bindur se virtytet shpirtërore duhet të jenë arma kryesore e saj, do të bëjë çmos që Shqipëria të shtrihej deri atje deri ku ishin kufijtë e saj etnikë dhe që të jetë, vërtet, e pavarur dhe e qëndrueshme. "Për fat të keq - do të shkruajë Ismail Qemali më vonë në Kujtimet e tij - ashtu si ndjek njerëzit e veçuar, Fati ndjek dhe popujt".

## Dëshpërimi i tij

Atë ditë të madhe, më 28 nëntor, kur fillon jeta e Shqipërisë së pavarur, atë ditë fillon edhe ecja e saj, e krijuesit të saj dhe e popullit të saj nëpër mundime. Shqipërisë do t'i shkaktohen të këqija, cenime, peripeci, prej fqinjëve ballkanikë, prej disa fuqive të mëdha evropiane, prej klasës së vet politike, prej trashtinës njerëzore. Luftërat Ballkanike dhe, menjëherë në vazhdim të tyre, Lufta Botërore, në të cilën për interesa të kundërta të Fuqive të Mëdha e të të mbrojturve të tyre të vegjël do të derdhet aq shumë gjak, do të shtojnë numrin e shkaktarëve të peripecive të Shqipërisë e të tragjedive të shqiptarëve. Konferenca e Ambasadorëve në Londër do t'i sjellë dëshpërim të madh popullit shqiptar dhe Ismail Qemalit. Jashtë kufijve të Shqipërisë ajo do të lërë më shumë se gjysmën e trojeve shqiptare dhe më shumë se gjysmën e popullit shqiptar! Serbisë, Malit të Zi dhe Greqisë do t'u jepen fushat më pjellore, burime të lumenjve, qytete të zhvilluara shqiptare! Se ç'përmasa ka papërgjegjësia historike e Fuqive të Mëdha në këtë Konferencë shihet në rastin e Kosovës e të Maqedonisë: ato do t'i jepen Serbisë edhe pse numri i serbëve që jetonin aty ishte gati i padukshëm!
Serbia i vazhdon përpjekjet për të dalë në det përmes Shqipërisë dhe një kohë e mban të pushtuar një pjesë të saj!
Mali i Zi bën çmos të rikthejë Shkodrën dhe gjithë Ultinën e saj.
Greqia pushton pjesën jugore të Shqipërisë dhe nuk heq dorë prej synimeve për përshtrirje sa më lart në veri!
Italia bën politikën e pushtimit të Vlorës e të Sazanit dhe të vënies së Shqipërisë nën protektoratin e saj!
Rusia e Franca, madje edhe Britania e Madhe, shteti - shpresë i Ismail Qemalit, shikojnë si ta bëjnë Serbinë sa më të madhe, kurse Franca nuk do të ngurrojë ta shpërblejë Greqinë me qytete shqiptare, si, fjala vjen, me Korçën!
Esat Pashë Toptani krijon kundërqeveri në Durrës, zhvillon fushatë të hapur me shpifje djallëzore kundër Ismail Qemalit dhe vihet në shërbim të Serbisë!
Anarkia e brendshme, që shfaqet gjithmonë e gjithkund pas rënies së sundimeve të gjata të dhunshme, varfëria, analfabetizmi i shtrirë dhe zia e bukës bëhen, po ashtu, rrezik për Shqipërinë dhe për qeverisjen e saj!
Fati i Shqipërisë dhe i Babait të saj ishin bërë Një.
I gjetur nën trysninë e Fuqive të Mëdha për arsye se donte të ishte subjekt e jo objekt i historisë, i braktisur nga bashkëpunëtorët arrivistë, i pa kuptuar nga një pjesë e madhe e bashkëkombësve, i shpërfolur e i akuzuar rrejshëm nga intrigantë, i lodhur nga mosha, i pushtuar nga një mosbesim për mundësinë e ndryshimit të shpejtë të gjendjes, Ismail Qemali më në fund lë Shqipërinë dhe rishtazi merr rrugën e mërgimit. Pesha mbi krahët e tij kishte qenë shumë e rëndë dhe ai nuk kishte mundur ta çonte më tutje. Si njeri që nuk dorëzohej lehtë ai, megjithatë, do ta vazhdojë luftën për Shqipërinë atje ku e kishte filluar: në qendrat politike evropiane. Kjo luftë tani nuk do të zgjasë shumë: perdja në fund të Dramës së tij jetësore do të bjerë më 26 janar 1919. Shqipëria me kufij të caktuar në Konferencën e Londrës më 1913 do të mbahet, por perdja në fund të dramës shqiptare nuk do të bjerë aq shpejt. Kjo dramë do të vazhdojë të luhet gjatë gjithë shekullit njëzet e, në kushte të tjera e në mënyra të tjera, me mundësi e me shpresa të tjera, vazhdon diku-diku të luhet edhe sot në fatin historik të shqiptarëve.
Nuk jam profet që ta di edhe sa kohë do të luhet kjo dramë. Shqiptarët kanë shumë arsye që t'u jenë mirënjohës përgjithmonë SHBA-ve dhe BE-së për të gjitha ato që kanë bërë për të ndalë dhunën shfarosëse serbe kundër tyre në Kosovë në vitin 1999 dhe për të gjitha ato që vazhdojnë t'i bëjnë për mbrojtjen e paqes në Kosovë. Por, nuk mund të mos thuhet se regjisorët e tragjedisë historike shqiptare në Kongresin e Berlinit (1878), në Konferencën e Londrës (1913) dhe në Konferencën e Paqes në Paris (1919) - shtetet e mëdha evropiane, po e dëgjojnë të mrrolura edhe sot jehonën e çështjes shqiptare ende të pazgjidhur përfundimisht, domethënë historikisht. Megjithëse për të janë shumë më të vëmendshme sesa paraardhëset e tyre para gati një shekulli, zgjidhjen e saj vazhdojnë ta lënë ende të pakryer para së gjithash duke e kundërshtuar bashkimin e Kosovës me Shqipërinë! E çështjet si kjo për të cilën është fjala këtu, kur lihen përgjysmë të zgjidhura, lënë mundësi për tendosje e konflikte.

## Shembulli i tij

Emri i Ismail Qemalit në historinë e popullit shqiptar mbetet përgjithmonë i shënuar si Shtetari, që themeloi Shqipërinë; si Demokrati liberal, që e filloi qeverisjen demokratike në jetën kombëtare dhe si Njeriu, që dhuntinë e tij politike e përdori në mënyrat më të denja për punët më të rëndësishme - domethënë mbetet i shënuar si personaliteti, që ka kryer mision prijës e parathënës në këtë histori. Është e kuptueshme pse pikërisht populli, njerëzit e thjeshtë me të cilët është përnjësuar ai, e kanë vlerësuar aq bukur këtë mision kur e kanë kënduar në vargjet:
Unë jam Smail Qemali
Pas meje vjen historia.
Lavdia e pa kaluar politike e shtetare meritohet edhe në sajë të dhuntive e virtyteve që e shquanin Ismail Qemalin: në sajë të kulturës çfarë e kishte Ai; në sajë të forcës morale, me të cilën i duronte tundimet e fatkeqësitë Ai; në sajë të ndershmërisë me të cilën shquhej Ai; dhe në sajë të sakrificave që për Atdheun e vet i bënte Ai.
Ai, i cili, si rilindësit e tjerë të mëdhenj, të gjitha pasuritë e veta lëndore, mendore, shpirtërore, ia dhuroi popullit të vet
Ai, Ismail Qemal Vlora, shembulli i madh i njeriut, i politikanit dhe i shtetarit në historinë e popullit shqiptar.

E jashtëzakonshme

# Gjendet lista 384-vjeçare e pazarit në shtëpinë historike në Angli



Arkeologët të cilët janë duke ndihmuar në restaurimin e një shtëpie historike në Kent të Anglisë kanë zbuluar një listë pazari të shekullit të 17, e cila ishte fshehur nën dyshemenë e saj. Lista që është zbuluar gjatë një rinovimi multi-milionësh të të famshmes "Knole House" është shkruar në vitin 1633. Shtëpia është ndërtuar në fund të shekullit 15 dhe është e rrethuar nga 1 000 hektarë pyje.

FOTO E DITES




Një grua e Bangladeshit mbart mbetje të riciklueshme mbi grumbujt e plehrave nën një urë këmbësorësh në Dhaka. /AFP/

E rrallë

# Taksia fluturuese kryen me sukses testet e para



Taksia fluturuese ka bërë testimet e para me sukses. Boeing ka bërë testin në një aeroport në Manassas të Virxhinias. Ai fluturoi në ajër për më pak se një minutë. Qëllimi ishte testimi i funksioneve autonome të mjetit elektrik dhe sistemet e kontrollit të tokës.

## BARSOLETA E DITËS



- Me çfarë veprimi mund ta zhbllokojë polici kaosin në udhëkryq?
- Vetëm nëse merr pauzë.

KINO ABC PRISHTINE

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

Në ora 16:00

## "THE GRINCH" 3D,



I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney



Në ora 17:30

## "THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS" 3D

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston

Në ora 19:30

## "MORTAL ENGINES" 3D,




Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Raftery, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers




Në ora 22:00

## "HUNTER KILLER",

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI** Nuk u keni kushtuar rëndësi të dashurve tuaj dhe njerëzve të afërt dhe kjo gjë do t'ju penalizojë sot. Do t'i shihni shumë larg vetes.



**DEMI** Nëse keni diçka interesante për të bërë sot, mund të dilni jashtë kornizave. Në të kundërt mos e ndryshoni fare vazhdimësinë e ditës.



**BINJAKËT** Sot jeni mjaft të ekzaltuar sepse do të merrni pjesë në një aktivitet disi të veçantë dhe që ka shumë anë misterioze për ju.



**GAFORRJA** Po merreni intensivisht për t'i shlyer një borxh moral një mikut tuaj. Ai ju është gjendur në çaste të vështira pranë dhe sot ka nevojë për ju.



**LUANI** Nëse do të bëni misteriozet sot me një person të saponjohur, do ta lini të krijojë përshtypje të gabuar për ju dhe për projektet tuaja.



**VIRGJËRESHA** Dikush ju ka vendosur pengesa në rrugën tuaj sot dhe do t'ju bëjë të humbni diçka me vlerë për të cilën kishit investuar prej kohësh.



**PESHORJA** Sot e keni të nevojshme të gjeni një person mjaft serioz për t'u marrë me një çështje të caktuar. Nuk mund t'u besoni atyre që ju rrethojnë.



**AKREPI** Mos u vini në sfidë me të tjerët sot sepse në kushtet në të cilat ndodheni nuk ju nevojitet. Jeni disa hapa para dhe duhet shumë punë për t'ju arritur.



**SHIGJETARI** Do të karikoheni me energji pozitive sot dhe çdo plan do të jetë në vijimësi të asaj çfarë keni rënë dakord me partnerin.



**BRICJAPI** Sot dikush do të mundohet të justifikojë para jush një sjellje aspak dinjitoze. Edhe pse nuk do të reagoni, tashmë nuk ju lidh asgjë me këtë person.



**UJORI** Nëse keni planifikuar diçka për sonte në darkë, mos e shtyni me pretekstin e vetëm që do të takoni një të panjohur.



**PESHQIT** Mezi po duroni bashkëjetesën me një person të caktuar sot. Jeni të lumtur që ky takim nuk do të zërë shumë orë të ditës tuaj.

# Demi Lovato shënon gjashtë muaj që nga shërimi



Demi Lovato është duke festuar një çast historik për shërimin nga mbidoza që nga korriku. Këngëtarja e "Skyscraper" ka shkruar një postim në "Instagram" se që gjashtë muaj është kthjellur dhe këtë ditë e ka shënuar me një tortë. "Dita më e mirë ndonjëherë", ka shkruar Lovato. Që nga sëmundja e mbidozës, Lovato përfundoi një trajtim 90 ditorë të rehabilitimit dhe u kthye ngadalë edhe në mediat sociale.

# Kourtney Kardashian me të dashur të ri?



Pas një flirtimi me modelin Luka Sabbat, 21-vjeçar, ajo u zbulua se kishte një takim me një burrë të ri në Malibu. Kourtney Kardashian kohët e fundit ka pranuar se ajo dëshiron të jetë "përsëri në dashuri" dhe tani ajo është zbuluar për 'lidhjen' e re. Kourtney 39-vjeçare u fotografua e buzëqeshur me një zeshkan me sy blu derisa ata u larguan nga restoranti ku darkuan.



# Rita Ora shkëlqen përsëri

Këngëtarja nga Prishtina, Rita Ora, së fundi mori pjesë me një ngjarje në Santiago të Chiles. Ajo aty pati një paraqitje të mrekullueshme si çdoherë. Ora pati të veshur pantallona ngjyrë roze dhe i shoqëroi ato me një çizme ngjyrë metali.

# Jenna Dewan e lumtur në krahët e të dashurit të ri



Jenna Dewan dhe Steve Kazee po duken shumë të dashuruar. Çifti është parë duke pritur për makinën e tyre pas një darke të shtunën në mbrëmje në Los Angeles. Jenna dukej mahnitëse në një fustan me lule, ndërkaq Steve pati të veshur një bluzë të zezë të kombinuar me pantallona gri.

## Pompeo përgëzon progresin e arritur në bisedimet me talebanët

**Uashington, 27 janar** - Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, e quajti "përparim të theksuar" dialogun për paqe me Afganistanin, pas gjashtë ditësh bisedime me talebanët në Katar, për t'i dhënë fund konfliktit 17-vjeçar. "Lajm inkurajues nga i dërguari i posaçëm i ShBA-së, Zalmay Khalilzad", tha Pompeo në "Twitter". "Ai ka raportuar progres të madh në bisedimet me talebanët", shtoi Pompeo. Pompeo po ashtu tha se Shtetet e Bashkuara janë të vendosura për ta ndjekur paqen dhe për t'i parandaluar sulmet terroriste ndërkombëtare në Afganistan. Uashingtoni po punon me Qeverinë afgane dhe të gjitha palët e interesuara për ta fuqizuar sovranitetin e Afganistanit, pavarësinë dhe prosperitetin. Ai shtoi se ende nuk është arritur ndonjë marrëveshje finale me militantët, por se bisedimet do të vazhdojnë përsëri.



# Rreziku nga ekstremistët, Gjermania mbyll dyert për emigrantët

Edhe pse para katër vjetëve kishte pranuar gati një milion refugjatë, Gjermania tani ka mbyllur në heshtje dritaren mbi aplikimet për azil dhe është duke e zhvilluar "betejën" nëpërmjet deportimeve

**Berlin, 27 janar** - Pothuajse katër vjet, pasi gati një milion refugjatë u pritën në vend, Gjermania ka mbyllur në heshtje dritaren mbi aplikimet për azil dhe është duke e zhvilluar "betejën" nëpërmjet deportimeve. Ky trend ka vazhduar edhe pasi numri i njerëzve që mbërrijnë në Evropë ka rënë me 80 % që nga kulmi i krizës së emigrantëve në vitin 2015, sipas OKB-së. Të mërkurën ministri i Brendshëm Horst Seehofer njoftoi se në 2018 Gjermania pranoi rreth 185 000 aplikime për azil, një rënie me 17 % krahasuar me vitin e kaluar dhe shumë më pak se kulmi që u regjistrua në vitin 2015 me 890 mijë kërkesa. "Tani e kemi problemin nën kontroll, i kemi vënë gjërat në rregull. Ne ofrojmë mbrojtje për njerëzit që janë pjesë e shtresave vulnerabël, megjithatë, popullsia jonë do të pranojë azilantë, nëse ne arrijmë të riatdhesojmë ata që nuk kanë nevojë të mbrohen", tha Seehofer. Ai me krenari deklaroi se shifra e azilkërkuesve është brenda "kufirit të sipërm" të migrimit të miratuar nga qeveria e koalicionit gjerman.

### Aplikimet kanë rënë, deportimet në rritje

Por ajo që ministri Seehofer nuk tha ishte se ndërsa numri i aplikimeve po bie, numri i deportimeve duket të jetë në rritje. Shifrat e Ministrisë së Brendshme të ofruara në përgjigje të një pyetjeje nga ligjvënësit e Partisë së Majtë tregojnë se pas krizës së emigrantëve numri i deportimeve gati është dyfishuar në 20 mijë deportimeve në vit dhe ka qëndruar përafërsisht në atë nivel që nga ajo kohë, pavarësisht prej rënies së madhe të të ardhurve. Vitin e kaluar më shumë se 8 000 njerëz u kthyen në vendet e Bashkimit Evropian, ku ata arritën herën e parë.

Shifrat e deportimit gjithashtu tregojnë se si vendet e BE-së vazhdojnë të grinden se kush duhet të jetë përgjegjës për azilkërkuesit që vijnë. Për shembull, Gjermania riatdhesoi më shumë se 30 % të emigrantëve në Itali, por Greqia refuzoi ta pranojë shumicën e kërkesave për transferim nga Gjermania dhe Hungaria nuk pranoi asnjë.

Shifrat japin gjithashtu një tregues të largimit të Gjermanisë nga "Wilkommenskultur" ose "kultura e mirëpritjes" që përshëndeti refugjatët në vitin 2015 kur kancelarja Angela Merkel i fitoi zemrat e gjermanëve me shprehjen "Wir Schaffen Das" ose "Ne mund ta bëjmë këtë".

### Vala e ekstremit të djathtë

Që atëherë, partia kundër emigracionit Alternativa për Gjermaninë (AfD) është rritur në sondazhe. Disa krime të profilit të lartë që përfshijnë emigrantët kanë zhvendosur opinionin publik, veçanërisht sulmet masive seksuale të Vitit të Ri 2015-16 në Këln, ku shumë gra u sulmuan nga bandat e "burrave të Afrikës së Veriut", sipas policisë.

Verën e kaluar protesta të dhunshme shpërthyen në rrugët e qytetit gjerman të Chemnitzit, pasi një burrë në lokal u qëllua me thikë nga dy emigrantë.

Sulmet ndaj qytetarëve kanë shtyrë partitë gjermane të qendrës për ta goditur imigracionin, veçanërisht Bashkimin Kristian Demokrat të Merkelit dhe partinë e saj bavareze, Bashkësia Kristiane Sociale (CSU), e cila ishte nën udhëheqjen e Seehoferit.

Por nuk ka asnjë garanci se linja e ashpër ndaj emigracionit do të bëjë që partitë e qendrës të Gjermani të fitojnë vota më shumë në zgjedhjet e ardhshme. Ndërsa Seehofer drejtoi të ashtuquajturin "Masterplan për migracionin" të Qeverisë, CSU humbi vota të cilat shkuan për të dyja AfD-në e djathtë dhe të Gjelbrit, duke kërkuar një politikë shumë më liberale të imigracionit në të majtë. Seehofer që prej atëherë është votuar si udhëheqës i partisë CSU.

### Vendet e sigurta

Javën e kaluar, Dhoma e Ulët e Bundestagut gjerman votoi për të vendosur në listën e saj të "vendeve të sigurta të origjinës" edhe Marokun, Algjerinë, Tunizinë dhe Gjeorgjinë, duke e bërë shumë më të vështirë për azilkërkuesit nga ato vende të fitojnë statusin e refugjatit. Sipas Ministrisë së Brendshme të Gjermanisë, më 2017 më shumë se 15 000 njerëz nga këto katër vende kanë aplikuar për statusin e refugjatëve, por vetëm shtatë prej tyre kanë marrë azil.

Rreth 300 shtetasve prej këtyre vendeve u është dhënë një formë e mbrojtjes së përkohshme humanitare, e cila nuk do të ndodhë më, nëse këto vende do të vendosen në listën "e vendeve të sigurta".

Ndërsa Seehofer tha se riklasifikimi do ta përshpejtonte procesin e aplikimit të refugjatëve, Luise Amtsberg, zëdhënësja e çështjeve të azilit për të Gjelbrit, nuk u pajtua me ministrin. "Unë personalisht mendoj se gjëja më e keqe në lidhje me këtë debat është se ai përpiqet t'i mashtrojë njerëzit në Gjermani duke menduar se riklasifikimi i këtyre katër vendeve mund t'i zgjidhë potencialisht problemet që kemi me politikat tona të azilit", tha ajo.

### Humbja totale e burimeve

Vendimi për të dëbuar më shumë emigrantë tani ka shkuar në një fazë të re, përtej aplikantëve të rinj. Pra, verifikimi po ndodh edhe për ato raste që kanë mbetur në një "fushë gri" ligjore për vite në Gjermani, thotë një avokat i imigracionit. "Ne shohim tani një lloj urgjence për t'i rritur shifrat e deportimit, për shembull të njerëzve që kanë jetuar në Gjermani për 30 vjet, janë të martuar me një gjerman ose kanë një fëmijë gjerman. Njerëzit që pothuajse me siguri do të mund të marrin përsëri vizën. Pra, është një humbje e plotë e burimeve", thotë Philipp Pruy, një avokat i imigracionit. "Pyetja është nëse ata mund të vazhdojnë me këto dëbime për një afat të gjatë, sepse kërkon një investim të madh financiar dhe njerëzor, pra të personelit. Për këtë duhet të realizohen zëvendësimet e pasaportave, të trajtohen personat e marrë në paraburgim, arrestimet e dorëzuara, aeroplanët e ngarkuar, ndaj dyshoj që mund t'ia dalim me këtë çështje me kaq shpejtësi", tha Pruy.









## Rusia përkujton 75-vjetorin e rrethimit të Leningradit

**Moskë, 27 janar** - Tanke dhe sisteme antiajrore të mbrojtjes parakaluan të dielën në qendër të Shën Petersburgut për ceremonitë e 75-vjetorit të heqjes së rrethimit të tmerrshëm të Leningradit që shkaktoi vdekjen e të paktën 800 000 personave mes viteve 1941 dhe 1944.

Parada, e cila u zhvillua nën flokët e dëborës pranë muzeut Hermitage, ngjalli edhe polemika, përfshirë nga të mbijetuarit e rrethimit, duke e denoncuar si një shembull të propagandës ushtarake të orientuar nga autoritetet.

Presidenti rus, me origjinë nga ky qytet, nuk ishte i pranishëm në paradë, por do të merrte pjesë në disa organizime të tjera të planifikuara në ishkryeqytetin rus.

Përpara qindra spektatorëve që sfiduan edhe të ftohtin ekstrem, mbi 2 500 ushtarakë parakaluan në shesh, shoqëruar nga tanku legjendar T-34 dhe raketahedhëse.



# Izet Sarajliqi, ky ballkanas i metamorfizuar

Albin MEHMETI

Tema e luftës në letërsi lindi së bashku me letërsinë. E kemi të njohur Luftën e Trojës që paraqitet në veprën "Iliada" të Homerit që konsiderohet ndër veprat e para të letërsisë botërore. Më pas, autorë nga popuj të ndryshëm paraqiten luftërat e konfliktet që ndodhën gjatë historisë. Në fundshekullin e kaluar në Ballkanin Perëndimor, përkatësisht ish-Federatën Jugosllave, shpërthyen katër luftëra të përgjakshme, gjithsecila më e rëndë se tjetra, por që kishin një emërues të përbashkët: agresorin e njëjtë. Ndër këto luftëra, ajo që solli më së shumti viktima e dëme ishte lufta e Bosnjës. Gjatë kësaj lufte mbahet mend rrethimi i egër i Sarajevës, kryeqytetit të Bosnjës dhe vendlindja e njërit prej poetëve më të njohur boshnjak, Izet Sarajliq, i cili për asnjë çast nuk e braktisi atë edhe pse e kishte mundësinë. Gjatë kësaj periudhe ai nuk e ndali punën që dinte ta bënte më së miri: të shkruante. Poezia është shqetësimi i shpirtit të tij. Sarajliqi jetoi me luftën e cila e preku në zemër, por edhe i vrau më të dashurit e tij. S'ka si të mos jetë ndryshe përveç se temë e poezive të tij jetë lufta, të cilën e përmbledhi në librin "Përmbledhja sarajevase e luftës", që në gjuhën shqipe na solli Shtëpia Botuese "Armagedoni", përkthyer mjeshtërisht nga Salajdin Salihu.

Vepra fillon me poezinë "Kënga e fundit para lufte", ku Sarajliqi profetizon të keqen që po vinte, duke portretizuar tjetrin, kulturën dhe dashurinë e tyre si diçka të huaj e të panjohur. Për dashurinë e tyre dyshon se mos nuk e kanë fare, duke i parë krimet e mizoritë që ata i bëjnë. Më pas, në poezinë "Sa të papërgatitur hyrën në këtë luftë", vazhdon linja sukcesive e fillimit të luftës, e një tmerri që do të ndodhte. Në këtë poezi, por edhe në gjitha poezitë e tjera, Sarajliqi e tejkalon vetveten dhe del nga identiteti i tij ballkanas, i cili në gjenet e veta ka urrejtjen për tjetrin. Sarajliqi thotë se ne ende nuk mund të urrejmë sa duhet (Sarajliq, 2017:11), pra edhe pse mizoria e luftës kishte filluar, ai nuk mund të urrejë askënd, pasi ai kishte vendosur të metamorfizohej nga ballkanasi urrejtës në një artist të vërtetë, ku urrejtja nuk do të ketë vend në zemrën e tij. Në gjithë poezitë e këtij cikli do të shohim edhe një fenomen tjetër të rrallë që do ta dëshmojë edhe më tepër metamorfizmin e Sarajliqit. Në asnjë të vetëm ai nuk e sheh luftën




si lavd, por si dhimbje njerëzore, gjë e rrallë mes ballkanasve, të cilët në poezitë e këngën e tyre asnjëherë të vetme nuk qajnë për humbjen, por këndojnë për fitoret, shpeshherë fitore të sajuara, të mbushura me mite, të pavërteta e urrejtje për tjetrin.

Në poezinë "Jugosllavët e dikurshëm" paraqitet lufta që Saraliq e quan luftë brenda llojit, pasi të njëjtit gjenden para tytave të të njëjtëve që për gjysmëshekulli jetuan në ideale të bashkim-vëllazërimit që, në fund të fundit, doli të jetë vetëm një farsë.

Në poezinë "Mizerje" autori komunikon me një shkrimtare serbe, dikur mikeshë e rinisë së tij. Ai e kujton të kaluarën e tij me të, atëherë kur punonin bashkë, kur kishin miq të përbashkët boshnjakë e serbë. Por në mes të kujtimeve të bukura të së kaluarës, ai ka një brengë në zemër, se mos vallë edhe ajo, e ndikuar nga nacionalizmi serb, do t'u bashkëngjitet bandave kriminale çetnike nga Paleja. Këtu, Saraliqi paraqet opiumin nacionalist, i cili, po të hyri në trup, më s'do njohësh miq e kujtime, humanitet e vlera e, mbi të gjitha, s'do mund ta njohësh as veten. Pikërisht kjo problematikë do të trajtohet edhe në poezinë "Shiba". Historia e regjisorit boshnjak Hajrudin Krvavac-Shiba dhe aktorit serb Bata Zhivojinoviq paraqet se deri në ç'shkallë mund të arrijë efekti i ideologjisë së urrejtjes. Nëse para lufte regjisori boshnjak e bëri të njohur aktorin serb, lufta demaskoi fytyrën e këtij të fundit, i cili i doli në krah regjimit diktatorial serb. Nëse deri dje ata ishin të pandarë, e sotmja i bëri armiq.

Thonë se koha i shëron plagët por, jo. Lufta një ditë do të përfundonte, por jo edhe plagët që Zhivojinoviq ia hapi Shibës. Sarajliqi këtë e paraqet përmes një metafore të fuqishme në vargjet: "Sa të përfundonte lufta; në rastin e parë; do t'i ndante një rol; Këtë herë; assesi një rol pozitiv; Heroi pozitiv; Bata Zhivojinoviq; kaherë ka varrosur vetën në vetvete" (Sarajliq, 2017: 20).

Në poezinë "Mëshirë njerëzore", që është ndër poezitë më të fuqishme të krijimtarisë së Sarajliqit, paraqet kulmin e luftës dhe ekzistencës së njerëzimit dhe vlerave të tij. Për Sarajliqin, mëshira njerëzore ka vdekur. Përmes pyetjes retorike: "Mëshirë njerëzore; Ku je? A thua vetëm në libra" (Sarajliq, 2017: 22), Sarajliq në bën me dije se për të mëshira është vetëm një utopi, e cila ka mbetur vetëm brenda kopertonave të librave, e mbyllur, e burgosur dhe e vrarë nga ata që nuk e duan mëshirën.

Por në mes të kësaj lufte, ai ka një shpresë, se "një ditë do të zgjohemi në paqe" (Sarajliq, 2017: 48), paqe që u arrit dikur, pas mijëra e mijëra viktimave, një paqe e përgjysmuar e një plage të hapur që ende po vazhdon të lëngojë qoftë në Bosnjë, po ashtu edhe në Kosovë. Por, nëse do dëgjohej zëri i zemrës së Sarajliqit dhe shumë sarajliqëve të tjerë, nuk do të kishte nevojë që të shërohej asnjë plagë, pasi s'do të ekzistonte plaga, pasi s'do të kishte dorë të urrejtjes që do ta shkaktonte atë.



## *Cikël poetik nga THOMAS NYDAHL*

*Thomas Nydahl ka lindur më 27 qershor 1952 në Malmoe të Suedisë. Është autor i 40 librave dhe gazetar i pavarur. Nydahl shkruan për jetën e vetmuar dhe tekstet e tij janë shpesh të zhveshura nga figuracioni. Nydahl është, gjithashtu, një shkrimtar tepër i përkushtuar në blogun e vet Nydahls kustvandringar. Shkrime të ndryshme të tij janë të publikuara në revistën finlandezo-suedeze "Astra Nova".*

### *ARTI I TË LINDURIT*

*Të hapësh shalët s'është mjaft*
*Të lindësh do të thotë të japësh jetë*
*Jeta vjen mahnitëse*
*Fëmijën e lind*
*veç dhembshuria për mish e gjak.*

### *ARTI I TË PIRIT*

*Ndjenjë lehtësimi*
*Vera në gojë: dritë dielli*
*që e lyen qiellzën kuq a bardhë, çdo grimë e lëkurës*
*shkrirë nga përqafimet e rrushit, befas*
*me një ndjesi që kaplon krejt kurmin.*
*Kokë e këmbë, duar e gjinj, sy e veshë,*
*vera i ngacmon ndërsa e lemë në punën e vet, të ngacmojë*
*e të përjashtojë. Ngacmon: shpatet e vreshtave.*
*Përjashton: zbrazëtinë dhe hallakatjen stresuese.*

### *ARTI I TË JETUARIT TË FADOS**

*Tek zgjohem një mëngjes, tek gjej një tjetër faturë*
*të paftuar, tek e gjej e mërzitem me të*
*Tek ulem në tavolinën e mëngjesit, tek marr*
*një vëllim të vjetër me poezi portugeze*
*Tek e lexoj, fjalë për fjalë, sikur të mësoja përsëdyti*
*si të lexoj: "Gjuhët e tyre, prej guri, gjithashtu",*
*tek rrekem ta nis ditën paçka faturës, tek rrekem*
*të rroj siç dikur më rrëfyen në Lisbonë: pa kurrfarë*
*iluzioni a hidhësie, por duke i pranuar ditët*
*siç vijnë e shkojnë, duke i parë si gurë kilometrikë*
*në një jetë vetë zgjedhur, në një jetë ndriçuar me*
*kujtime netësh të vona me fado dhe dashuri diellore*

*________*
** Fado - muzikë folklorike portugeze, zakonisht melankolike, ose valle që shoqëron këtë lloj muzike.*

### *ARTI I LARGIMIT PREJ DITËS KOMBËTARE*

*Pri biletë veç për ikje, hipi*
*trenit. Në tren ngulu*
*deri në ndalesën e fundit. Këqyre imët*
*qytetin ku ke mbërritur,*
*po s'pe ndonjë flamur a të tjera*
*simbole kombëtare të vendit tënd,*
